



Raporti Vjetor 2019



Puna e fondacionit në vitin 2019

Aktivitetet e fondacionit ne vitin 2019 kanë qenë të drejtuara nga agjenda e ndërtimit të një shoqërie të hapur në Kosovë, që është pjesë e një strategjie afatmesme, ndërtuar dy vite me parë. Premisat kryesore që e përcaktojnë këtë agjendë, mbeten njëkohësisht edhe sfidat më serioze me të cilat ballafaqohet shoqëria Kosovare, që më shumë se dy dekada. Vlerat e një shoqërie të hapur në Kosovë janë të rrezikuara nga jashtë dhe brenda vendit. Fondacioni është marr me që të dy aspektet: (1) Izolimin e vendit që vjen nga procese ndërkombëtare të pa-përfunduara si dhe (2) vendosja e një kulture të pa-ndëshkueshmërisë brenda tij, janë dy aspekte të rëndësishme brenda të cilave fondacioni e ka ndërtuar strategjinë e vet të veprimit. Objektivat e gjera ishin:

(1) **Luftimin e izolimit të vendit**, që del nga një proces mjaft i ngadalësuar i pranimit të shtetësisë së tij në nivel ndërkombëtar. Fondacioni nuk mund të bëjë shumë për pranimin e shtetit të ri, por ka vazhduar të avokojë për një angazhim më të madh të shteteve që nuk e kanë njohur akoma shtetësinë e Kosovës. Për sa kohë pranimi formal është një akt politik dhe diplomatik fondacioni nuk ka mundur dhe as që ka tentuar t'i stimulojë këto procese; por në anën tjetër gjatë tërë vitit janë ndërmarr hapa që do të stimulonin një angazhim më intensiv të vendeve mos-njohëse për bashkëpunim ndër-shtetëror në të gjitha nivelet. Në këtë drejtim individë dhe përfaqësues të shoqërisë civile vizituan shumë qendra Europiane. Një theks të veçantë, gjatë vitit 2019, e kemi pas në intensifikimin e bashkëpunimit rajonal si dhe në sfidat bilaterale, siç janë Negociatat Kosovë – Serbi.

(2) **Shtylla e dytë e veprimit të fondacionit në 2019**, e që del nga korpusi i luftimit të problemeve

që shoqërinë Kosovare e mbajnë gjithnjë e më shumë të mbyllur është **Luftimi i kulturës së mos-ndëshkueshmërisë** duke ngritur transparencën, llogaridhënien dhe integritetin e institucioneve vendim-marrëse. Në këtë drejtim fondacioni është marr me aktivitete komplekse që dalin nga disa programe afatgjate, siç janë, Integrimet Europiane, Luftimi i korrupsionit dhe ngritja e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve qeveritare, dhe (4) Luftimi i korrupsionit (akademik) në Universitetin e Prishtinës.

(3) **dhe në fund, i tërë opusi i aktiviteteve që sjell në tërësi të veprimit integrimin dhe mbrojtjen e të drejtave minoritare** është përmbledhur në Programin Ri-lidhja e Mitrovicës që gjithnjë e më shumë bëhet titull simbolik për tentativat e vazhdueshme të fuqizimit të sektorit civil në vendet ku jetojnë serbët, sepse në vitin 2019 një pjesë e madhe e aktiviteteve të organizuara nga ky program kanë qenë të vendosura në rajonet tjera, jashtë Mitrovicës.

Sikur edhe viteve të mëparshme, fondacioni në punën e tij ka qenë i mbështetur fuqimisht nga faktet që (1) tashmë ka grumbulluar mjaft eksperiencë me punën që ka bërë në këto fusha dhe ka pas rezultate konkrete që na inkurajojnë për te vazhduar; (2) ka bashkëpunim të frytshëm me rrjete të forta individësh dhe organizatash brenda dhe jashtë vendit në mbështetje të objektivave të caktuara; (3) Posedon platforma të fuqishme avokimi për te influencuar vendim-marrjen adekuate.

Një përcaktim i shënuar i fondacionit në vitin 2019 ka vazhduar të jetë fuqizimi i rrjeteve dhe koalicioneve të organizatave jo-qeveritare, që në këtë fazë veprojnë si partnerë të fondacionit, në realizimin e qëllimeve programore, por, në një të ardhme afatshkurtër këto rrjete do të vazhdojnë punën si të pavarura.

Partneriteti me këto rrjete dhe koalicione organizatash civile, e mundëson adresimin e suksesshëm të problemeve madhore me të cilat merremi, sepse sjell shumë më shumë ekspertizë, si në potencialin hulumtues ashtu edhe në ngritjen e platformave avokuese rreth çështjeve me të cilat merremi. Kjo qasje është treguar deri tash shumë e qëlluar, dhe fondacioni e ka nxitur themelimin e të paktën dy rrjeteve të tilla: KITU (Koalicioni për integritet dhe transparencë në Universitet) si dhe Pro-Open që punon në projekte anti-korrupsion dhe prokurim publik. Një rrjet i ngjashëm, por jo-formal punon në çështjet e integritetit Europian, si dhe brenda komuniteteve etnike në veri të vendit dhe në Gracanicë, të lidhura rreth Qendrave të Energjisë Qytetare që fondacioni i ka themeluar vitet e kaluara.

Struktura programore e ngritur, rrjetet e partnereve programor si dhe infrastruktura avokuese e fondacionit (Forum 2015, Open 333, CEC dhe Bisedat e Mbrëmjes) ka vite që ka krijuar nje veprim sinergjik me projektet operationale (Koncepte) si dhe grant dhënie direkte (Fusha), të cilat mund t'i përshtaten në mënyrë shumë fleksibile rrethanave programore të caktuara, si mjet efikas për ta sfiduar demokracinë Kosovare që vazhdon te jetë shumë e brishtë. Projektet e mëdha operationale kanë qenë pjesa më aparente e veprimit të fondacionit në vitin 2019.

Në këtë vit fondacioni ka vazhduar të punojë në katër drejtime strategjike, analiza e të cilave është bërë në vazhdim të këtij raporti, si dhe ka vazhduar të punojë në adresimin e dy sfidave politike dhe zhvillimore që na i solli ky vit (me fonde rezervë). Po ashtu fondacioni ka vazhduar të punojë, me financimin e palëve të treta, siç është BE dhe fondacioni Gjerman Karl Kubel Stiftung (KKS), në adresimin e problemeve të komuniteteve RAE në lëmin e arsimit. Gjatë vitit 2019 projekti disa vjeçar i realizuar me fonde të BE-së në përkrahje të arsimit të komuniteteve RAE ka përfunduar, ndërsa projekti i cili adreson nevojat në arsim dhe fusha sociale i përkrahur nga KKS do të vazhdoj deri në vitin 2022. Po ashtu projektet e financuara nga fondi rezervë i OSF që kishin të bëjnë me fuqizimin e palës Kosovare në negociatat Kosovë-Serbi si

dhe projekti që është realizuar së bashku me fondacionin në Shqipëri me titull “de-kompozimi i mitit të bashkimit Kombëtar” kanë përfunduar.

RAPORTI FINANCIAR

PASQYRA PERMBLEDHESE FINANCIARE E SHPENZIMEVE të KFOS-it

për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2019

Nr.	Specifikimi	Buxheti Euro	Shpenzuar Euro	% e Shpenzuar
1	Mjetet e buxhetit bazë për vitin 2019			
	Koncepti 1 - Rilidhja e Mitrovices	377,938.22	377,938.22	100.00
	Koncepti 2 - Përafrimi i institucioneve publike të Kosovës me Standarde të BE-së.	458,885.12	458,885.12	100.00
	Fusha 1 - Ngritja e transparencës dhe llogaridhënja	276,807.30	276,807.30	100.00
	Fusha 2 - Programi i Edukimit të lartë	244,303.37	244,303.37	100.00
	Shpenzimet per administrimin e programeve	188,396.69	188,396.69	100.00
	Shpenzimet Administrative	247,816.13	247,816.13	100.00
	Sub-Totali 1:	1,794,146.83	1,794,146.83	100.00
2	*Mjetet e buxhetit të fondit rezervë dhe të rrjetit për vitin 2019			
	Mjetet e FonditRezerve - Dialogu Kosove - Serbi	96,565.00	96,565.00	100.00
	Mjetet e FonditRezerve - Projekti Kosove - Shqiperi	119,667.83	119,667.83	100.00
	Mjetet e OSIFA per Konceptin 2.	90,157.12	90,157.12	100.00
	Mjetet e rrjetit per Edukimin e larte	31,726.67	31,726.67	100.00
	Sub-Totali 2:	338,116.62	338,116.62	100.00
3	Mjetet e buxhetit të dontorëve tjerë për vitin 2019			
	Fondet e Bashkimit Evropian	120,884.50	120,884.50	100.00
	Karl Kubel Shtiftung	141,092.02	141,092.02	100.00
	Balkan Tender Watch	27,363.52	27,363.52	100.00
	Sub-Totali 3:	289,340.04	289,340.04	100.00
	Totali i buxhetit dhe shpenzimeve:	2,421,603	2,421,603	

Buxheti i shpenzuar sipas programeve (euro)




Figura 2. Shpenzimet e bera sipas muajve




Figura 1. Buxheti i shpenzuar i ndare sipas kategorive finansuese





FIGURA 4. SHPERNDARJA E GRANTEVE SIPAS VLERES SE TYRE - (EURO)





PROGRAMI EVROPIAN



PROGRAMI EVROPIAN

Ankorimi i institucioneve publike të Kosovës në standardet dhe politikat e BE-së dhe përmirësimi i statusit ndërkombëtar të Kosovës

Përmbledhje

Ndonëse Kosova nënshkroi marrëveshjen e parë kontraktuale me Bashkimin Evropian në vitin 2015, institucionet e Kosovës vazhdojnë të jenë larg prej arritjes së standardeve evropiane. Për më tepër, kthimi kah fryma nacionaliste në shtetet anëtare të BE-së, sidomos ato që ende nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, është një indikator negativ për perspektivën evropiane të saj.

Në ndërkohë në Kosovë, përkundër hapave pozitive të bëra në drejtim të adresimit të kërkesave të Komisionit Evropian, një seri zhvillimesh politike që nisën me vendosjen e tarifës 100 për qind mbi produktet nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina në dhjetor 2018, i mbajtën relacionet e Kosovës me fqinjët dhe Brukselin në tension gjatë gjithë vitit.

Vendosja e njëanshme e tarifës nga qeveria Haradinaj çoi në tërheqjen e Serbisë nga procesi i dialogut të ndërmjetësuar nga Brukseli, duke zhbërë çfarëdo hapa të ndërmarrë drejt finalizimit të marrëveshjes gjithpërfshirëse. Në anën tjetër, zgjedhjet e Parlamentit Evropian në mars dhe formimi i ngadalshëm i institucioneve të reja, proces i cili zgjati deri në dhjetor, e la BE-në në një vakuum institucional pa shumë autoritet për të bërë presion ose shtyrë politikën e vet për bashkëpunim rajonal.

Në qershor, i ftuar për intervistë nga Gjykata Speciale në Hagë, Kryeministri Ramush Haradinaj

dha dorëheqje duke e futur kështu vendin në një krizë institucionale për pjesën tjetër të vitit.

Shpërbërja e parlamentit dhe dorëheqja e qeverisë rezultuan në pezullimin e iniciativave politike, dhe patën efekt të paikshëm edhe në agjendën legislative duke shtyer shumë iniciative pozitive, madje edhe adoptimin e Agjendës së Dytë për Reforma Evropiane (ERA 2).

Dorëheqja e Haradinaj e çoi vendin në zgjedhje të parakohshme në tetor, ku dolën fituese partitë opozitare, Lëvizja Vëtvëndosja dhe Lidhja Demokratike të Kosovës. Ndonëse rezultatet e zgjedhjeve sinjalizuan që qytetarët e Kosovës donin ndryshim, kriza politike në vend vazhdoi të thellohet dhe partitë fituese nuk kanë arritur të formojnë një koalicion qeverisës deri në momentin e shkrimit të këtij raporti në janar 2020.

Në këtë sfond të zhvillimeve politike të brendshme dhe ndërkombëtare, Fondacioni vazhdoi të punojë në drejtim të nxitjes dhe përkrahjes së reformave evropiane në vend. Përpjekjet e veta Fondacioni i fokusoi në dy drejtime: së pari duke përdorë perspektivën evropiane të vendit për të avokuar për reforma, dhe së dyti, vazhdoi të të punojë në forcimin e perspektivës evropiane duke zgjëruar lidhjet me shtetet e Evropës që nuk e njohin shtetësinë e Kosovës.

Për t'i realizuar këto Fondacioni është fokusuar në:

1. Përkrahjen e moduleve të "Thellimit të nojhurive mbi BE-në" në sektore kyçe të agjendës evropiane
2. Përkrahjen e përpilimit të hulumtimeve që rrisin njohurinë për relacionet e Kosovës me BE-në dhe monitorimin e zbatimit të obligimeve kontraktuale

3. Përkrahjen e rrjetit të hulumtuesve të rinj nga vendet mosnjohëse (BE dhe rajon) dhe zgjerimin e rrjetëzimit mes shoqërisë civile të Kosovës dhe këtyre vendeve
4. Vazhdimin e avokimit për një marrëveshje përfundimtare me Sërbinë duke përkrahë një dialog mes të gjitha partive politike në Kosovë me qëllim të arritjes së konsensusit

Gjatë vitit 2019, Fondacioni ka përkrahur shoqërinë civile në vend për të monitoruar progresin e Kosovës në përmbushjen e standardeve evropiane, duke vazhduar të mbështesë një sërë organizatash që kanë hulumtuar, monitoruar, dhe avokuar përafrimin e institucioneve të Kosovës me BE-në brenda sektoreve të ndryshme.

Përveç kësaj Fondacioni ka inicuar dhe mbështetur botimin e publikimeve dhe organizimin e diskutimeve që kanë adresuar ndryshimin e klimës politike në Evropë po edhe në rajon në lidhje me procesin e integritit evropian të shteteve të Ballkanit Perëndimor, në veçanti pasi që Këshilli Evropian shtyu hapjen e negociatave për anëtarësim të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.

Për më tepër, gjatë vitit 2019, Fondacioni intensifikoi përpjekjet e veta për të krijuar lidhje në mes shoqërisë civile dhe politikë-bërësve të Kosovës me ata në Bruksel, shtetet mosnjohëse evropiane e shtetet e rajonit, duke organizuar diskutime të hapura e të mbyllura në Sërbi, Belgjikë, Shqipëri, Greqi dhe Spanjë.

Në anën tjetër pas suksesit të dy gjeneratave të para, Fondacioni vazhdoi të përkrahë 12 hulumtues të rinj nga vendet evropiane dhe rajoni, puna origjinale e të cilëve do të diseminohet në vendet e tyre përkatëse dhe përmes botimeve evropiane. Iniciativa e rrjetëzimit të hulumtuesve të rinj dhe shoqërisë civile nga Kosova me vendet mosnjohëse përkrahen nga buxheti bazë dhe fondi Think-Tank nga OSIFE.

Për të vazhduar punën në fuqizimin e pozitës së Kosovës karshi dialogut me Sërbinë, Fondacioni ka vazhduar projektin operacional me partnerët

e saj nga Gjermania dhe Kosova, të përkrahur nga fondi rezervë dhe një shtesë një-vjeçare të buxhetit bazë. Përkundër suspendimit të procesit të dialogut, dhe mungesës së Qeverisë dhe Parlamentit, Fondacioni vazhdoi të punojë me politikë-bërës në Kosovë dhe jashtë saj për të adresuar mundësitë e vazhdimit të dialogut dhe zgjeroi aktivitetet e veta për të përfshirë edhe komunitetin serb në Kosovë si pjesë të procesit.

Thellimi i njohurive mbi BE-në

Si pjesë e objektivit të vet për përmirësimin e qeverisjes dhe demokratizimit të mëtutjeshëm të vendit, Fondacioni është i përkushtuar të mbështesë shoqërinë civile në Kosovë për të qenë pjesë e politikbërjes në vend, gjithnjë duke pasë parasysh standardet dhe obligimet që dalin nga *acquired* dhe MSA-ja.

Në rend të parë, kjo objektivë përkthehet në angazhimin e Fondacionit për të përkrahur organizata të shoqërisë civile për të prodhuar njohuri në lidhje me procesin e integritit evropian, ndërsa në rend të dytë për t'i dhënë atyre mjete për të avokuar tek institucionet vendore dhe ato të kyçura në proces në lidhje me rezultatet e hulumtimeve të tyre.

Si mjet për të arritur këtë qëllim, Fondacioni ka inicuar dhe mbështetur organizimin e moduleve të ashtuquajtura "Thellimi i njohurive mbi BE-në," të cilat ngërthejnë në vete punëtori, përpilim të dokumenteve pozicionuese mbi tema relevante që dalin nga obligimet e marra përsipër nga Marrëveshja për Stabilizim-Asociim (MSA), dhe avokim për reformë politikash. Modulet zakonisht rezultojnë në punëtori intensive me akterët kyç nga institucionet publike, shoqëria civile dhe mediat. Këto module fokusohen në sektore specifike duke i dhënë hapësirë organizatave të shoqërisë civile të monitorojnë, hulumtojnë dhe analizojnë tema të ndryshme në thellësi.

Në mars të vitit 2019, Fondacioni organizoi një punëtori planifikuese dhe konsultuese me një grup të gjërë organizatash të shoqërisë civile për

të diskutuar sektoret ku intervenimi i Fondacionit përmes programeve të tij do të ishte më emergjent. Ky takim i cili përfshiu vet grant-marrësit potencial në grant-bërje (participatory grant making), u organizua bashkarisht me Programin e Transparencës dhe Llogaridhënies. Gjatë takimit përfaqësuesit e shoqërisë civile e vlerësuan si të nevojshme që edhe një segment i moduleve të “Thellimit...” do të duhej të fokusoheshin në dy tema të mëdha: mbrojtjen e ambientit dhe qasjen në dokumente.

Përgjatë tërë vitit, organizata të ndryshme janë angazhuar për të hulumtuar dhe avokuar brenda drejtimeve tematike, duke mbuluar kështu tema të ndjeshme nga impakti ekonomik dhe ambiental i ndërtimit të termocentralit të ri Kosova e Re, e deri tek mundësia për të ulur ndotjen e ajrit në qytetin e Prishtinës, i cili çdo dimër rangohet si një nga qytetet me ajrin më të dëmshëm në botë.

Si pjesë e këtij intervenimi, në maj të vitit 2019, **Instituti Riinvest** organizoi një punëtori të suksesshme ku mbledhi përfaqësues të Kuvendit të Kosovës, ekspertë të energjetikës, përfaqësues të shoqërisë civile dhe të mediave në një punëtori për të diskutuar efektet e vendimin për të ndërtuar termocentralin e ri dhe për të avokuar ndalimin e ratifikimit të projektit nga Kuvendi i Kosovës. Dokumenti i politikave i titulluar **“Sektori i energjisë në udhëkryq: Termocentrali i ri, një ide e vjetër?”** i botuar si pjesë e këtij projekti avokues, përmbledh argumentet kryesore në lidhje me atë se si një termocentral i ri jo vetëm se është i dëmshëm për ambientin dhe ekonominë e Kosovës, po edhe do të bëhej pengesë e paevitueshme karshi proceseve integruese në BE.

Ndonëse kontrata për ndërtimin e termocentralin e ri nuk erdhi në votim në legjislaturën e kaluar, tema e termocentralit ishte një nga temat kyçe të diskutuara gjatë zgjedhjeve të tetorit 2019 dhe mbetet prioritet për Kuvendin e ri dhe Qeverinë e ardhshme të Kosovës. Për të avokuar në këtë drejtim, Fondacioni po ashtu komisionoi një animacion për t’i shpjeguar argumentet kyçe të dala nga konsultimet e bëra brenda këtij projekti për t’i njoftuar edhe votuesit në lidhje me problemin.

Një tjetër projekt me mjaft impakt brenda këtij intervenimi ishte edhe **projekti i kryesuar nga Organizata për Demokraci, Anti-Korrupsion dhe Dinjitet, Çohu!**, e cila e orientoi shkollën e vet tradicionale të gazetarisë hulumtuese në një platformë për të promovuar mbulimin mediatik të çështjeve të ambientit. Pas një monitorimi dhe analize të mbulimit paraprak, Çohu në bashkëpunim me Rrjetin për Raportimimn e Krimet dhe Korrupsionit, KRIK, organizuan një punëtori 4-ditore të fokusuar në metodat e hulumtimit gazetaresk dhe ekspertizën minimale të nevojshme për të mbuluar shkeljet e mëdha mjedisore. Si pjesë e projektit, Çohu edhe shpërndau një shpërblim për artikullin më të mirë ambiental në fund të vitit 2019, gjë që kishte impakt pozitiv në nxitjen e mbulimit të çështjeve mjedisore.

Disa nga projektet e përkrahura si pjesë e kësaj objektivite do të vazhdojnë të realizohen edhe gjatë vitit 2020, kur edhe do të zgjerohet fokusi tematik për të mbuluar edhe lajmet e rrejshme dhe shpërndarjen e keqinformimit - një temë që Fondacioni dëshiron të adresojë gjatë vitit 2020.

Tabela e granteve dhe shpenzimeve të tjera programore:

Titulli i projekti	Grantist	Shuma në euro
Zonat me emetim të ultë	Qendra Kosovare për Avokim dhe Zhvillim , KADC	7,725.00
Punëtorja e KADC” Zonat me emetim të ultë” 14.-16.06.2019	Operacional	8,861.44
Sektori i energjisë në udhëkryq: problemet dhe opsionet	Instituti Riinvest	4,800.00
Organizimi i punëtorisë në bashkëpunim me Riinvest “Sektori i energjisë në udhëkryq” me datë 17-19.05. 2019	Operacional	4,289.98
Shkolla e Gazetarisë Hulumtuese – tema degradimi i ambientit	Organizata ÇOHU	10,200.00
Punëtorja/ Çohu -KRIK “Shkolla e gazetarisë hulumtuese: degradimi i ambientit” 07-11.06.2019	Operacional	13,703.63
Monitoruesi Mjedisor	Ec Ma Ndryshe	9,910.00
Kriteri i Tenderit Ekonomikisht më të favorshëm – Sa jemi të gatshëm?	Instituti Demokratik i Kosovës, KDI	4,000.00
Punëtorja e KDI “Kriteri i Tenderit Ekonomikisht më të favorshëm” 15-17.11.2019	Operacional	5,343.85
Fakenews dhe shkolla për gazetari hulumtuese	Organizata Çohu	18,000.00
Ndotja nga ndërtimi	Ec ma ndryshe	10,000.00
Së bashku për mjedise pa tym duhani	Qendra Kosovare për Avokim dhe Zhvillim , KADC	10,700.00
	Subtotal	107,533.90
Shpenzime Programore		
Takim planifikues me organizata të shoqërisë civile 22-24.03.19 në Tiranë, Shqipëri	Operacional	5,686.22
Ofrim i shërbimeve të ilustrimit për animacion dhe publikim	Operacional	1,105.26
Publikim dhe printim	Operacional	1,000.00
Shpenzime tjera administrative programore	Operacional	6,540.88
	Subtotali	14,332.36
Totali		121,866.26

Monitorimi i procesit të integritimit evropian dhe avokimi për reforma

Gjatë dy dekadave të fundit, kushtëzimi i BE-së ka luajtur një rol të fuqishëm për të shtyrë reforma në mbarë vendet e Ballkanit Perëndimor. Edhe në Kosovë, fondet e BE-së dhe kushtëzimi gradual në rrugën drejt integritimit evropian kanë qenë shtytje pozitive për institucionet e Kosovës të adoptojnë reforma drejt garantimit të rendit dhe ligjit, respektimit të drejtave të njeriut, dhe zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

Në vijë me Strategjinë, gjatë vitit 2019 Fondacioni ka përkrahur organizata dhe akterë të shoqërisë civile për të bërë monitorimin e implementimit të prioritetëve të Marrëveshjes për Stabilizim Asociim (MSA). Për shkak të krizës institucionale që pasoi me dorëheqjen e Kryeministrit, qeveria e Kosovës nuk arriti të adoptojë Agjendën e Dytë për Reforma Evropiane (ERA II).

Përkundër krizës institucionale përmes grantistëve të ndryshëm, Fondacioni ka vazhduar të punojë në nxitjen e plotësimit të obligimeve ndaj BE-së duke punuar me nivelin e shërbimit civil.

Për të arritur objektivin e vet strategjik Fondacioni ka vepruar në dy drejtime. Në njërin anë Fondacioni ka përkrahur financiarisht organizata që kanë monitoruar masat dhe prioritetet e parapara në dokumentet shtetërore, duke vlerësuar dhe nxitur kështu avancimin e Kosovës në rrugëtimin evropian. Për më tepër, Fondacioni ka mbështetur financiarisht organizata që kanë përpiluar dokumente politikash për të avokuar për ndryshime të kornizës ligjore apo politikave specifike.

Në anën tjetër Fondacioni ka iniciuar dhe mbështetur projekte të cilat janë marrë aktivisht me pasojat e ndryshimeve politike brenda BE-së pas zgjedhje parlamentare dhe ardhjes së Komisionit të Ri, duke adresuar çështjen e stagnimit të procesit të zgjerimit drejtpërsëdrejti.

Si grant dhënës, Fondacioni ka përkrahur organizata për të hulumtuar e përpiluar dokumente

politikash, e më pastaj për të avokuar në sektorë të ndryshëm: prej reformës së administratës publike, e deri tek rritja e transparencës dhe integritetit në policinë e Kosovës.

Instituti i Prishtinës për Studime Politike, PIPS, për shembull, është marrë me adresimin e çështjes së reformës administrative, në veçanti të ristrukturimit të agjencive të pavarura. Ky proces i filluar tash e sa vite, ende s'ka marrë formë finale dhe është një nga prioritetet e agjendës evropiane në Kosovë, duke e bërë pjesëmarrjen e shoqërisë civile të domosdoshme.

Në anën tjetër **Grupi për Studime Ligjore dhe Politike, GLPS**, kanë vazhduar monitorimin e përmbushjes së kriterëve të vendosura nga BE-ja në MSA, duke mbështetur plotësimin e tyre përmes avokimit tek institucionet përkatëse të përfshira në këtë proces, një projekt i filluar në vitin e kaluar.

Në ndërkohë Fondacioni ka përkrahur edhe analiza të tjera që do të botohen në fillim të vitit 2020, duke përfshirë hulumtimin e realizuar nga **Instituti i Kosovës për Politika Evropiane, EPIK**, në lidhje me fondet e BE-së që do të jepen si pjesë e IPA III, filluar nga vitit 2021.

Në të njëjtën kohë që Fondacioni ka vazhduar të shtyjë përpara reformat shumë të nevojshme për vendin, ai e ka pasur të pamundur të injorojë zbehjen e perspektivës evropiane për Ballkanin Perëndimor, sidomos pas shtyerjes së pa afat të heqjes së vizave për qytetarët e Kosovës, dhe shtyerjen e hapjes së negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë.

Për të adresuar ndryshimin e disponimit në vet BE-në dhe sidomos pas botimit të dokumentit francez i cili bën thirrje për të ndryshuar procesin e anëtarësimit, Fondacioni komisionoi përpilimin e analizës "Metodologjia e re e zgjerimit: Pengesë apo inspirim?". Lancimi i analizës me 11 dhjetor u shoqërua me një debat të suksesshëm e mjaft të gjallë në të cilën morën pjesë autorët e raportit, Augustin Palokaj dhe Gjeraqina Tuhina, si dhe ambasadorja franceze në Kosovë, Shkëlqesia e Saj Marie-Christine Butel.

Tabela e granteve dhe shpenzimeve të tjera programore:

Titulli i projektit	Grantist	Shuma në euro
Me Institucionet Efikase më Afër BE-së	Qendra Kosovare për Avokim dhe Zhvillim, KADC	16,000.00
Monitorimi i zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në fushën e reformës së administratës publike	Instituti i Prishtinës për Studime Politike, PIPS	8,677.46
Kosova në IPA III: Sfidat dhe Risitë	Instituti i Kosovës për Politika Evropiane, EPIK	5,909.46
Monitorimi i zbatimit të MSA-së në lidhje me racionalizimin e agjencive të pavarura	Instituti i Prishtinës për Studime Politike, PIPS	10,000.00
Mungesa e transparencës dhe llogaridhënies e vështirëson deradikalizimin e të kthyerve në Kosovë	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, KMDLNj	8,000.00
Fuqizimi i integritetit në Policinë e Kosovës	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, QKSS	20,000.00
Profili i migrantit potencial	Grupi për Studime Juridike dhe Politike, GLPS	15,200.00
Qytetarët në qendër të gazetarisë	Kosovo Glocal	15,000.00
Ri-organizimi i Qeverisë: organizimi i ministrive, trajtimi i nëpunësve civil tepriçë dhe strukturave të tipit të inspektorateve brenda ministrive të fuzionuara	Demokrati plus	9,960.00
Shërbime konsulence për analizën “E ardhmja e relacioneve BE-Kosovë pas zgjedhjeve evropiane”	Operacional	5,254.03
Shërbime konsulence për analizën “Metodologji e re e zgjerimit evropian: Pengesë apo inspirim”	Operacional	5,388.55
Subtotali		119,389.50
Shpenzime programore		
Publikim dhe printim		1,537.59
Shërbime përkthimi		225.92
Shpenzime tjera programore		6,540.88
Subtotali		8,304.39
Totali		127,693.89

Përmirësimi i lidhjeve në mes të Kosovës dhe shteteve mosnjohëse

Dështimi i Kosovës për tu anëtarësuar në Interpol në fund të vitit 2018 simbolikisht shënoi fillimin e një periudhe të vështirë në politikën e jashtme. Prej vendosjes së tarifës 100 % – vendim që u kritikua ashpër nga BE-ja dhe partnerët tjerë ndërkombëtarë – e deri tek një seri çnjohjesh të shtetësisë së saj, viti 2019 e gjeti Kosovën gjithnjë e më të izoluar. Gjatë këtij viti, nuk pati ndonjë lëvizje në pozicionim të pesë vendeve anëtare të BE-së që ende nuk njohin pavarësinë - një pengesë serioze për perspektivën evropiane të vendit. Madje në shtator, pas një humbje të në loje futbollit në mes të kombëtares çeke dhe reprezentacionit kosovar, presidenti çek e diskutoi mundësinë për të tërhequr njohjen e Kosovës.

Në rajon, vendosja e tarifës, ngurtësoi edhe më shumë relacionet mes Kosovës dhe dy fqinjëve të saj, Bosnjën e Hercegovinën dhe Sërbisë.

Këto zhvillime e bënë edhe më esencial intervenimin e Fondacionit në rrjetëzimin e shoqërisë civile, politikbërësve dhe artistëve të Kosovës me ata të vendeve mosnjohëse dhe trasimin e kanaleve të reja të komunikimit mes këtyre shoqërive. Kjo iniciativë për zhvillimin e lidhjeve dhe shkëmbimeve me shoqëritë civile në shtatë vendet që s’e kanë njohur Kosovën përkrahet nga buxheti bazë dhe fondi Think-Tank nga OSIFE.

Për vitin e tretë me radhë, Fondacioni vazhdoi mbështetjen e rrjetit të hulumtuesve të rinj nga vendet mosnjohëse për të sfiduar perceptimet stereotipike dhe mungesën e njohurive për Kosovën. Ky projekt, jo formalisht i quajtur **“Ndërtimi i njohurive për Kosovën (Building knowledge about Kosovo)”** ka prodhuar një grumbull shkrimesh nëpër publikime evropiane e rajonale në gjuhë të ndryshme, një vëllim me artikuj akademikë, një botim me shkrime të shkurtra, dhe ka vazhduar t’i prezantojë rezultatet e punimeve nëpër organizime të ndryshme diseminuese.

Në vitin 2019 Fondacioni ka botuar një vëllim serioz të hulumtimeve origjinale të prodhuar nga hulumtues të Evropës dhe rajonit të titulluar **“Local and international determinants of Kosovo’s statehood”** - rezultat i një punë një vjeçare të mentorëve dhe hulumtuesve të rinj nga cikli i dytë.

Në të njëjtën kohë, Fondacioni ka përzgjedhur një grup të ri hulumtuesish nga Spanja, Maqedonia e Veriut, Greqia, Sërbia, Bosnja dhe Hercegovina, Zvicra, etj. Për të punuar së bashku me mentorë të kualifikuar në hulumtimin e çështjeve të ndryshme të identitetit kosovar, shtetësisë, perspektivës evropiane dhe dialogut Kosovë-Sërbë, në mes të tjerash.

Cikli i tretë i rrjetit do të përfundojë punën në fillim të vitit 2020, kur edhe Fondacioni do të fokusohet në formalizimin e rrjetit dhe do të vazhdojë të punojë në rrjetëzimin e alumnive.

Një tjetër sukses i Fondacionit në këtë objektiv ishte botimi i librit **“The politics of recognition and engagement,”** të redaktuar nga Ioannis Armatolas dhe James Ker-Lindsay, nga botuesi prestigjioz Palgrave Macmillan. Libri, vëllim me artikuj nga akademikë dhe ekspertë të Ballkanit, është rezultat i një pune mbi dy-vjeçare të inicuar dhe mbështetur nga Fondacioni për të analizuar se si politikat e ndryshme që shtetet e BE-së (ato mosnjohëse dhe aleate) kanë ndaj Kosovës, i ndikojnë shanset e përmirësimit të statusit të saj ndërkombëtar. Në dhjetor, libri u promovua edhe në London School of Economics and Political Science në Londër, ku disa nga autorët e librit dhe redaktorët prezantuan punën para komunitetit akademik.

Gjatë vitit 2019, Fondacioni ishte shumë aktiv edhe në mirëmbajtjen e lidhjeve mes shoqërisë civile në Kosovë dhe asaj në vendet mosnjohëse.

Duke ndjekur një qasje që prek disa objektiva në të njëjtën kohë, Fondacioni organizoi një seri tryezash për të nxitur debat në lidhje me perspektivën evropiane të Kosovës dhe dialogun me Sërbinë, duke i targetuar shtetet mosnjohëse dhe rolin që ato mund të luajnë në këto çështje.

Në mars, në bashkëpunim me Forumin për Marrëdhënie Etnike (FER), Fondacioni organizoi një panel diskutimi në lidhje me dialogun Kosovë-Sërbë, në Beograd me përfaqësues të shoqërisë civile të dy vendeve duke hapur kështu një debat të dyanshëm mbi benefitet dhe pasojat e dialogut. Gjatë vitit 2019, Fondacioni po ashtu vazhdoi të përkrahë edhe festivalin tradicional “Mirëdita, Dobardan!”, i cili në fund të majit sollti në Beograd artistë, filma e muzicentë nga Kosova duke vazhduar të kontribuojë në hapjen e dy shoqërive ndaj njëra tjetrës.

Në fund të nëntorit, në bashkëpunim me Fondacinin Helenik për Çështje Evropiane dhe të Jashtme, ELIAMEP, Fondacioni organizoi një takim në Athinë. Suksesi më i madh i këtij intervenimi ishte edhe organizimi i suksesshëm i një ngjarje tërë-ditore në Madrid të Spanjës pikërisht për të diskutuar dialogun në mes Kosovës dhe Sërbisë dhe rolin e Spanjës në këtë proces, sidomos pas zgjedhjes së ish-Ministrit të saj të Jashtëm si përfaqësues i diplomacisë evropiane.

Tabela e granteve dhe shpenzimeve tjera: Buxheti bazë

Titulli i projektit		Grantist	Shuma në euro
Shërbime konsulence në lidhje me themelimin dhe rritjen e rrjetit të hulumtuesve "Building knowledge about Kosovo" Gjenerata e Tretë	Operacional		18,000.00
Organizim i punëtorisë në Selanik 30.05.-02.06.19 dhe përkrahje për projekte të vogla hulumtimi pjesë të projektit "Building knowledge about Kosovo"	Operacional		38,502.19
Festivali Mirëdita Dobardan 2019	NGO "Integra"		25,000.00
Qeveria e re: Çfarë tani?	Instituti i Kosovës për Politika Evropiane, EPIK		4,980.66
Vizitë studimore e 12 hulumtuesve në Prishtinë 15-21.09.19	Operacional		8,206.66
Takim planifikues për zhvillimin dhe zgjerimin rajonal të rrjetit "Building knowledge about Kosovo" III, 6-10.03.19	Operacional		6,635.77
Organizimi i tryezës me ELIAMEP në Athinë "Adresimi i sfidave të Ballkanit Perëndimor" me 28.11.19	Operacional		1,935.55
Mbështetje për promovim të librit "Politics of Recognition" në London School of Economics me 4.12.19	Operacional		631.72
Organizim i tryezës me Elcano dhe ECFR në Madrid, 11-15.12.19	Operacional		2,928.80
	Subtotali		106,821.35
Shpenzime programore			
Shpenzime tjera administrative programore	Operacional		6,540.88
	Subtotali		6,540.88
		Totali	113,362.23

Tabela e granteve dhe shpenzimeve tjera: Buxheti nga fondi rezervë OSIFE

Titulli i projektit	Grantist	Shuma në euro
Përkrahje për projekte të vogla hulumtimi pjesë të projektit "Building knowledge about Kosovo" gjenerata e tretë	Operacional	39,917.00
Debatimi i qeverisë së re në Kosovë dhe e ardhmja e dialogut Beograd-Prishtinë	Fondacioni Helenik për Çështje Evropiane dhe të Jashtme, ELIAMEP	3,020.00
Fuqizimi i debatit konstruktiv publik mbi politikën e jashtme të Kosovës dhe relacionet politike me Bashkimin Evropian	Instituti i Prishtinës për Studime Politike, PIPS	5,500.00
Shërbime konsulence për redaktim, mentorim dhe kordinim të rrjetit të hulumtuesve "Building knowledge about Kosovo" 3.0	Operacional	14,000.00
Vizitë studimore e 12 hulumtuesve në Prishtinë 15-21.09.19	Operacional	8,206.66
Takim planifikues në Tiranë 22.24.03.19	Operacional	2,686.22
Tryeza e rrumbullaktë me EPC në Bruksel " Stuck in Limbo? The Future of Pristina-Belgrade dialogue" me 20.11.19	Operacional	2,245.36
Organizimi i tryezës me ELIAMEP në Athinë "Adresimi i sfidave të Ballkanit Perëndimor" me 28.11.19	Operacional	1,752.69
Mbështetje për promovim të librit "Politics of Recognition" në London School of Economics me 4.12.19	Operacional	2,085.06
Organizim i tryezës me Elcano dhe ECFR në Madrid, 11-15.12.19	Operacional	3,004.06
Subtotali		82,417.04
Shpenzime programore		
Publikim dhe printim		7,149.88
Shpenzime tjera administrative programore		590.20
Subtotali		7,740.08
	Totali	90,157.12

Fuqizimi i perspektivës së Kosovës në dialog me Serbinë

Duke e parë siç është të rëndësishme së madhe, në vitin 2018 Fondacioni inicioi një projekt për të adresuar mungesën e konsensusit në mes të partive politike në Kosovë rreth dialogut Kosovë-Sërbi. Në bashkëpunim me Democratization Policy Council (DPC) nga Berlioni dhe duke i përfshirë organizatat e shoqërisë civile në Kosovë, Fondacioni nisi një projekt gjithpërfshirës të partive politike në Kosovë për t'i përafuar qëndrimet në mes partive dhe për të fuqizuar perspektivën e Kosovës në finalizimin e një marrëveshje gjithpërfshirëse dhe ligjërisht obligative me Sërbisë.

Projekti i cili u përkrah nga Fondi Rezervë i Open Society Foundations gjatë vitit 2018 dhe 2019, u pa si shumë aktual dhe relevant, dhe për këtë arsye Fondacioni ishte përfitues i një rritje unike në një vjeçare të buxhetit bazë. Kjo rritje u nda në dy programe të Fondacionit, Rilidhja e Mitrovicës dhe tek Programi Evropian.

Përkundër suspendimit të dialogut në mes të dy vendeve në dhjetor 2018, gjatë tërë vitit Fondacioni ka vazhduar të avokojë për arritjen e një konsensusi në mes partive, formulimin e një platforme të përbashkët dhe ka përkrahur iniciativën për të nxitur debat në mes akterëve lokalë dhe ndërkombëtar.

Për një shpjegim të detajuar të iniciativës, referojuni seksionit tek Fondi Rezervë në fq. 65. Shpenzimet e bëra si pjesë të buxhetit bazë janë të renditura më poshtë. Për buxhetin e plotë, duke përfshirë atë të Fondit Rezervë, referojuni tabelave në fq. 68.

Tabela e granteve

Titulli i projektit	Grantist	Shuma në euro
Dialogu diplomatik: Një paradigmë e re për Kosovën dhe Sërbinë	Forumi për Marrëdhënie Etnike, FER	3,580.00
Autostrada Biennale II "Revolucioni jemi ne"	Autostrada Biennale	12,000.00
Sfidat e reja në rrugën e integritimeve evropiane	Instituti Riinvest	9,320.00
Tryeza e rrumbullaktë me EPC në Bruksel "Stuck in Limbo? The Future of Pristina-Belgrade dialogue" me 20.11.19	Operacional	5,245.36
Organizimi i tryezës me ELIAMEP në Athinë "Adresimi i sfidave të Ballkanit Perëndimor" me 28.11.19	Operacional	2,817.23
Mbështetje për promovim të librit "Politics of Recognition" në London School of Economics me 4.12.19	Operacional	1,453.33
Organizim i tryezës me Elcano dhe ECFR në Madrid, 11-15.12.19	Operacional	3,932.70
Shërbime konsulence ndërlidhur me zyrën e Nju Jorkut	Operacional	13,912.77
Shërbime konsulence ndërlidhur me zyrën e Nju Jorkut	Operacional	13,952.42
Shërbime konsulence për iniciativën "Fuqizimi i perspektivës së Kosovës"	Operacional	20,800.00
	Subtotali	87,013.81
Shpenzime programore		
Publikim dhe printim		4,268.66
Shërbime përkthimi		1,026.57
Shpenzime tjera administrative programore		3,653.81
Subtotali		8,949.04
Totali		95,962.85
Grand Total i Programit		549,042.34



**TRANSPARENCA
DHE LLOGARIDHËNIA**



TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA

Përmbledhje

Në vitin 2019 nuk mund të thuhet se ambienti politik kishte bërë lëvizje të shquara në drejtim të reformimit të administratës, sidomos jo në lëmitë që ne kemi mbuluar. Pikat më të ndjeshme mbeten ato që kanë të bëjnë me implementimin e ligjit, sidomos kur kemi të bëjmë me prokurimin publik, i cili mbetet relativisht mirë i mbuluar me legjislacion përcjellës dhe me infrastrukturë digjitale. Problemet më të shprehura janë të lidhura me interpretimin eventual të procedurave dhe mos aplikimin e ligjit në të gjitha fazat e implementimit.

Administrata vazhdoi edhe këtë vit të jetë mjaft inerte dhe e pa interesuar të ndërmerr hapa reformues. Fondacioni tentoi gjatë tërë vitit 2019 të rikrijojë një bashkëpunim me administratën publike në nivel qendror për të vazhduar punë në hapjen e të dhënave, por vështirë arrihen hapa konkret në këtë bashkëpunim sepse përkrahja mbetet gjithmonë vetëm deklarative. Përndryshe Ministria e Administratës Publike këtë vit i ka ndaluar aktivitetet për të bërë diçka konkrete me konsulencë të jashtme dhe me një grant të dhënë për një organizatë të vendit, që i ka krijuar hapësirë për intervenim fondacionit – sidomos për vitin 2020.

Qeveria gjatë 2019 ka marrë disa vendime që kanë hasur në rezistencë të madhe të shoqërisë së gjerë civile në rend të parë në lidhje me projektin e termocentralit të ri, minihidrocentraleve dhe së fundmi lejeve për ndërtim fare afër liqenit të Badovcit.

Në fushën e ngritjes së transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve qeveritare, gjatë vitit 2019 Fondacioni ka vazhduar me

implementimin e strategjisë dhe planit të veprimit. Strategjia është përqëndruar në (1) sistemin e prokurimit publik në Kosovë, specifikisht me analizimin e rasteve konkrete të shkeljeve gjatë procedurave të prokurimit, (2) në përgatitjen sa më të mirë për nismat ndërkombëtare nga e cila do të përfitojë shoqëria Kosovare, Open Data (hapja e të Dhënave) si pjesë e iniciativës globale OGP (Open Government Partnership) dhe (3) projektet zhvillimore, sidomos ato në fushën e ambientit, që kanë gjeneruar një spektër të abuzimeve, duke sjellur në dyshim përcaktimin e administratës për të respektuar pushtetin e ligjit. Gjithashtu, fondacioni ka vazhduar të punojë ngusht edhe me rrjetin e organizatave të shoqërisë civile – Pro Open, të cilin e kishte themeluar vite më parë, e që me qasje të përbashkët vihet në funksion të ngritjes së transparencës dhe uljes së abuzimeve me paratë e taksapaguesve.

Gjatë këtij viti, në të gjitha fushat e lartëcekura kemi pasur angazhime specifike, të cilat kanë arritur të sjellin shumë rezultate konkrete:

Prokurimi Publik

Sa i përket shtyllës së parë - prokurimit publik, këtë vit fondacioni është fokusuar më tepër në qasjen në dokumente publike, e cila megjithë legjislacionin në fuqi, nuk implementohet në mënyrë të kënaqshme. Gjatë punës sonë disa vjeçare, por edhe me intervenimet e donatoreve tjere (gjithnjë të koordinuara), është arritur që të funksionalizohet sistemi i prokurimit elektronik (e-procurement), me ç'rast të gjitha kontratat tashmë bëhen publike në këtë sistem. Sistemi ka mangësi të cilat duhet të adresohen edhe

në të ardhmen. Psh, jo secili qytetar mund të ketë qasje në sistem – është dizajnuar që vetëm autoritetet kontraktuese dhe bizneset të kenë qasje. Edhe përkunder faktit që të gjitha kontratat bëhen tashmë publike, jo i gjithë dokumentacioni përcjellës është i qasshëm. Për të analizuar një procedurë apo një kontratë prej fillimit deri në fund, nuk mjaftojnë vetëm informatat që gjenden në portal. Andaj, Fondacioni në vitin 2019 është fokusuar më tepër në lehtësimin e qasjes në dokumente zyrtare. Kjo është bërë me partnerët e fondacionit, të cilët kanë analizuar praktika të ndryshme rajonale, hierarkinë e ligjeve në fuqi (pasiqë shumë shpesh zyrtarët argumentojnë mos lejimin e qasjes në dokumente me legjislacion dytësor, etj). Kemi arritur që të vetëdijsojmë edhe qytetarët por edhe zyrtarët se afatet ligjore për lejimin e qasjes në dokumente duhet të respektohen.

Projekte me fonde të palëve të treta dhe grante nga programet tematike të OSF

Përveç buxhetit bazë, fondacioni gjithashtu punon edhe me fonde të palëve të treta dhe grante nga programet tematike të rrjetit OSF në projekte dhe iniciativa të ndryshme. Dy prej tyre, e që i takojnë domaint të prokurimit publik janë edhe (a) Balkan Tender Watch (BTW) – “Rankimii sistemeve te Prokurimit Publik në Ballkanin Perendimor”, projekt katër vjeçar i financuar nga Bashkimi Evropian, si dhe (b) “Nxitja e angazhimit kundër-korrupcion i organizatave lokale në fushën e arsimit dhe shëndetësisë në Ballkanin Perëndimor” financuar me fondet tematike të rrjetit OSF.

Lista e projekteve të organizatave të mbështetura në shtyllën e prokurimit publik dhe shpenzime tjera:

Emri i Projektit	Grantist	Shuma në Euro
Ngritje e llogaridhënies përmes prokurimit publik transparent	Iniciativa Qytetare Skenderaj	13,500.00
Vlerësim i Shoqërisë Civile për Institutin Albanologjik të Kosovës dhe dialog publik rreth këtij institucioni të veçantë të financuar nga fondet publike	Integra	25,765.00
Transparenca dhe përgjegjësia e institucioneve - rruga drejt Bashkimit Evropian	Medija Centar	8,958.00
Permirësimi përmes avokimit i Trajtimit të Lendeve në Prokurim Publik	Cohu	18,350.00
	Subtotal	66,573.00
Shpenzime programore		
Publikim dhe printim	Operacional	5,078.76
Shërbime të përkthimit	Operacional	391.97
Shpenzime tjera administrative programore	Operacional	3,039.74
	Subtotal	8,510.47
	Total	75,083.47

Balkan Tender Watch – Rankimi i sistemeve të Prokurimit Publik në Ballkanin Perëndimor

BTW është koalicion i organizatave të shoqërisë civile i angazhuar për të luftuar dhe parandaluar korrupsionin, e që synon të shndërrohet në një qendër të komunitetit kundër-korrupsion në Ballkanin Perëndimor, i aftë për të zhvilluar qasje politike, për të mbrojtur masat e propozuara, për të monitoruar në vazhdimësi politikatat kundër-korrupsion, veçanërisht në fushën e prokurimit publik, dhe për të ofruar përgjigje ndaj qasjes rajonale të paraqitur nga BE. Anëtarët e koalicionit BTW janë Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS; Fondacioni i Shoqërisë së Hapur, Serbi; Qendra për komunikim civil, Maqedonia Veriore; Rrjeti për afirmimin e sektorit të OJQ-ve - MANS, Mali i Zi si dhe Fondi i Shoqërisë së Hapur - Bosnje dhe Hercegovinë. Qëllimi i këtij projekti është rritja e ndikimit të shoqërisë civile të Ballkanit Perëndimor në politikatat dhe praktikatat kundër-korrupsion gjatë ciklit të prokurimit publik, duke shfrytëzuar integrimin në BE si agjendë transformuese.

Projekti synon të ndikojë në qeveritë e këtyre vendeve për të futur reforma që do të mundësojnë krijimin e sistemeve të përgjegjshme të prokurimit publik në përputhje me rregullat e BE-së, dhe ndërtimin e aleancave me autoritetet publike - të gatshme për t'u angazhuar në reforma.

Gjate vitit të dytë të implementimit - 2019, projekti ka trajnuar 10 organizata lokale (grassroot) duke i pajisur ata me veglën krahasuese (benchmarking tool), ku dy nga to kanë përfituar edhe nën-grante për të implementuar projekte të vogla në komunat e tyre. Nën-grantet u janë dhënë organizatave direkt nga OSF Serbia. Gjithashtu, në dhjetor është mbajtur konferenca e dytë rajonale në Podgoricë, në të cilën u prezentua studimi krahasimor, i cili përfshinë të gjitha shtetet që janë pjesë e projektit. Nga Kosova kanë marrë pjesë gjithsej 15 persona, nga shoqëria civile, mediat, dhe zyrtarë nga qeveria.

Nxitja e angazhimit kunder-korrupcion i organizatave lokale në fushën e arsimit dhe shëndetësisë në Ballkanin Perëndimor

Projekti tjetër që vjen si bashkëpunim midis programeve tematike të OSF është edhe “Nxitja e angazhimit kundër-korrupcion i organizatave lokale në fushën e arsimit dhe shëndetësisë në Ballkanin Perëndimor”. Kjo iniciativë ka filluar në fund të 2019 dhe do të zhvillohet në 6 vende të Ballkanit Perëndimor: Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Serbi.

Qëllimi i projektit është lidhja i hendekut midis organizatave lokale aktive në shëndetësi dhe arsim dhe organizatave profesionale (të nivelit qëndror) kundër korrupsionit. Aktorët profesionistë të kundër-korrupsionit kanë njohuri dhe aftësi për të luftuar korrupsionin, por kanë potencial të ulët mobilizimi, ndërsa grupet lokale (grassroot) dhe shoqatat (pacientët, prindërit etj) kanë mungesë të njohurive për tu përballur me korrupsionin, por kanë një potencial më të theksuar mobilizimi. Bashkimi i forcave të tyre do të forcojë përpjekjet kundër korrupsionit duke siguruar angazhim të besueshëm të këtyre palëve të interesuara në adresimin e korrupsionit - bazat themelore të cilave do të forcojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre kundër korrupsionit. Partnerë të projektit nga Kosova janë: në nivel qëndror – Demokraci Plus, ndërsa në nivel lokal (grassroot) – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim - ORCA dhe Instituti Columbus. Deri tani janë identifikuar rastet që do të analizohen, si në shëndetësi ashtu edhe në arsim; janë dërguar kërkesat për qasje në dokumentacion, ndërsa gjatë vitit 2020 do të bëhet analizimi i rasteve dhe shpalosja e rezultateve.

Lista e projekteve të organizatave të mbështetura me fondet e palëve të treta dhe grante nga programet tematike të OSF:

Emri i Projektit	Grantist	Shuma në Euro
Balkan Tender Watch – Rankimii sistemeve të Prokurimit Publik në Ballkanin Perendimor	Operacional	27,363.52
Nxitja e angazhimit kundër-korrupsion i organizatave lokale në fushën e arsimit dhe shëndetësisë në Ballkanin Perendimor	Demokraci Plus	13,852.49
Nxitja e angazhimit kundër-korrupsion i organizatave lokale në fushën e arsimit në Ballkanin Perendimor	ORCA	8,937.09
Nxitja e angazhimit kundër-korrupsion i organizatave lokale në fushën e shëndetësisë në Ballkanin Perendimor	Instituti Columbus	8,937.09
	Total	50,153.10

Hapja e të Dhënave

Në anën tjetër, shtylla e dytë, ajo e hapjes së të dhënave ka pasur ngecje, dhe kjo në njërin anë për shkak të mungesës së vullnetit politik për të vazhduar tutje me iniciativën, ndërsa në anën tjetër edhe për shkak të shpërbërjes së kuvendit që nga gjysma e vitit. Fondacioni ka ndihmuar gjatë katër viteve të fundit në krijimin e kushteve për fillim të hapjes së të dhënave, ka shtyer përpara aprovimin e kartës për hapjen e të dhënave, ka ndihmuar në krijimin e një plani konkret të veprimit ka organizuar trajnime të ndryshme, si për qeveritarët, ashtu edhe për shoqërinë civile, gjithmonë duke e ritheksuar rëndësinë e hapjes së të dhënave dhe benefiteve që mund ti gëzojmë nga kjo iniciativë për ngritje të transparencës. E gjithë iniciativa ka mbetur tek inventarizimi i data seteve ekzistuese nëpër institucione, ndërsa po pritet krijimi i qeverisë së re në mënyrë që të vazhdohet me implementimin e plotë të kësaj iniciative. Është e nevojshme që gjatë 2020 të krijohen data-squads, të cilët do të ndihmojnë secilën ministri në inventarizim, prioritizim dhe përpunim të të dhënave, të cilat pastaj duhet të bëhen publike pa kërkesa të veçanta (open by default). Në mënyrë paralele, edhe për kundër ngecjes së iniciativës si të tërë, fondacioni me partnerët e saj ka vazhduar

me aktivitete specifike, të cilat shpiejnë në hapje të të dhënave. Gjatë punës në prokurim publik kemi vërrejtur se vetëm bërja publike e kontratave nuk mjafton që të analizohet i tërë procesi i implementimit të kontratës dhe të identifikohen pikat e rrezikuara nga korrupsioni. Kemi filluar që të bëjmë presion edhe të thesari i shtetit, gjegjësisht ministria e financave, që të bëhen publike pagesat që shteti i kryen ndaj operatorëve ekonomikë. Kjo do ti ndihmojë organizatat e shoqërisë civile, por edhe qytetarët që të mund të analizojnë projekte konkrete prej fillimit deri në fund. Shkeljet që bëhen më së shpeshti janë mospërputhshmëria e pagesave që behen shumat e kontratave që nënshkruhen. Për këtë arsye, për të shtuar transparencë edhe më tepër, edhe gjatë vitit 2020 do të vazhdojmë të bëjmë presion që të hapen të gjitha pagesat nga thesari.

Lista e projekteve të organizatave të mbështetura në shtyllën e hapjes së të dhënave dhe shpenzime tjera:

Emri i Projektit	Grantist	Shuma Euro
Katalogu dhe analiza e qasjes në dokumente publike	Grupi per Studimet Juridike dhe Politike - GLPS	23,200.00
Monitorimi dhe promovimi i Ligjit për Mbrotjen e të Dhënave Personale dhe Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve	FOL!	24,145.00
Transparenca e plotë në shpenzime të parasë publike përmes hapjes së transaksioneve të thesarit	Demokraci Plus	19,690.00
	Subtotal	67,035.00
Shpenzime programore		
Publikim dhe printim	Operacional	3,555.13
Shërbime të përkthimit	Operacional	274.38
Shpenzime tjera administrative programore	Operacional	2,127.82
	Subtotal	5,957.33
	Total	72,992.33

Menaxhim i iburimeve natyrore

Shtylla e tretë e programit të transparencës dhe llogaridhënies është edhe menaxhimi i burimeve natyrore dhe anëtarësimi i koalicionit Pro Open në iniciativën globale për transparencë si Publish What You Pay – PWYP.

Për shkak të fleksibilitetit që fonacioni ka, gjatë vitit kemi intervenuar edhe në mënyrë ad-hoc me disa iniciativa që janë paraqitur nga qytetarët. Gjate me shume se nje viti, qytetarët e komunës së Shtërpçës kanë kundërshtuar ndërtimin e një hidrocentrali në lumin Lepenc, i cili kishte filluar të ndërtohej në lokacion me vendbanim të dendur, e që parashihet të shkaktoj probleme me ujë të pijshëm dhe ujë për ujitje. Që në fillim të involvimit, është gjetur se këta banorë kishin mbajtur mbi 200 protesta qe nga viti 2015, megjithatë nuk kishin marr vëmendjen as të qeverisë e as mediave. Pas involvimit tone, duke filluar me koordinimin e protestës me 1 korrik 2019, ky problem kishte marr një theks të veçantë në përditshmërinë kosovare, duke qenë temë e

vazhdueshme e raportimit në media vendore, madje edhe ato ndërkombëtare. Më 8 tetor 2019, duke shfrytëzuar aktualitetin e paszgjedhjeve, kur banorët ishin duke protestuar, policia kishte përdorur dhunë të tepërt ndaj protestuesve, duke mos kursyer as fëmijët nga përdorimi i “pepperspray”. Me partnerin tone KDI janë ndihmuar banorët dhe është koordinuar mbështetja me OJQ-të për mjedis, shoqatat alpiniste dhe dashamirët e mjedisit, në mbajtjen e një proteste me datën 10 tetor 2019, ku kishin marr pjesë mbi 600 protestues nga radhët e banorëve dhe OJQ-ve. Kjo protestë kishte tërhequr edhe vëmendjen e komunitetit ndërkombëtar, duke u raportuar edhe në BBC e Reuters. Gjithashtu, KDI kishte organizuar një debat të realizuar nga “Jeta në Kosovë”, ku ishin ballafaquar, institucionet, banorët dhe investitori. Debati kishte arritur mbi 74 mijë shikime.

Në vazhden e përkrahjes për këtë iniciative, kemi organizuar mbledhjen e nënshkrimeve për një peticion që është shtrirë në të gjithë territorin e Kosovës, përfshirë edhe lokacionet e vogla, që ishin më të prekura nga kjo ngjarje. Peticioni ka mbledhur rreth 28,000 nënshkrime, të cilat do ti dorezohen kuvendit të ardhshëm, posa të funksionalizohet. Partnerë në këtë

iniciativë ishin: KDI, Ec Ma Ndryshe, INPO, REC Kosova, Aktiv, Gjethi, KADC, dhe ERA. Aktiviteti i petitionit është shoqëruar edhe me një fushatë mediale, ku gjatë disa javëve rresht, anëtarët e ndryshëm të koalicionit në debate televizive (KTV – Interaktiv, T7 – Pressing) por edhe rubrika tjera televizive, janë përbërur direkt me zyrtarët e lartë shtetërorë – përgjegjës për këtë gjendje, por edhe me investitorët. Kërkesa kryesore e petitionit ishte zhvillimi nga ana e qeverisë i një plani kombëtar – gjithëpërfshirës për ujrat, në të cilin do të shënoheshin lokacionet rreptesisht të ndaluara për ndërtimin e mini hidrocentraleve dhe hidrocentraleve të vogla. Në asnjë moment nuk është kërkuar ndalimi i zhvillimit të sektorit të energjisë, mirëpo kërkohet që investimet të bëhen në bazë të studimeve të mirëfillta të fizibilitetit, të cilat janë të mangëta, dhe të zhvillohet një analizë e përgjithshme e vlerësimit të kapaciteteve të ujit në secilin lokacion – të vihen vijat e kuqe aty ku assesi nuk guxon të ndërtohet, dhe të shënohen vendet ku një gjë e tillë është e mundur, gjithmonë duke e vënë në prioritet mbrojtjen e ambientit.

Në mars 2019, Pro Open edhe zyrtarisht është bërë pjesë e Publish What You Pay, një grup i organizatave joqeveritare që punojnë për ngritje të transparencës në sektorin nxjerrës. Me këtë, edhe obligimet nga koalicionit Pro Open janë rritur. Kemi punuar që ta ushqejmë sekretariatit me analiza të ndryshme të sektorit nxjerrës në Kosovë, por edhe kemi organizuar paraqitje të përbashkëta si koalicion duke i trajtuar çështjet me rëndësi për ambientin.

Në fund të vitit, më saktësisht më 3 dhjetor, kemi organizuar një panair të titulluar Ekologji(k) a kosovare. Ky panair mjedisor ishte pjesë e një serie eventesh që i kemi përmbledhur me emrin “Odisejë”. Pas edukimit të lartë Fondacioni dhe koalicioni Pro Open kanë sjellur temën e rradhës - mjedisin, dhe këtë event e kemi quajtur Odisejë: Ekologjik(k)a kosovare. Eko sistemin tonë e kemi sjellur brenda një kornize logjike, dhe pasi që i vendosëm të gjitha ato që i dimë për cilësinë e mjedisit që na rrethon, na rezultoi përseri, si në shumë fusha jetësore, se duhet ta fillojmë një rrugë me shumë peripeti, një Odisejë, për ta

avansuar cilësinë e ajrit që e thithim, ujit që e pijmë dhe tokës që na ushqen.

Shoqëria civile ka rol të veçantë për të ndihmuar në çështjet mjedisore. Qëllimi i panairit ishte jo vetëm të raportojë për abuzimet që i bëhen këtij sektori, siç kemi bërë në këtë Panair, por edhe t'i prijë një procesi që do t'i sjell vlerat e duhura për të nisur reformën e madhe mjedisore. Së pari, ajo duhet t'i nxisë të gjithë akterët të bëhen pjesë e një Plani Kombëtar Mjedisor, dhe pse jo t'i prijë këtij procesi, duke e sjell në vëmendje të institucioneve qeveritare, civile, bizneseve, mediave, shkollave dhe universiteteve dhe mbi të gjitha duke e mbajtur të gjallë interesimin qytetar për rreziqet që na kanosen nga një mjedis i ndotur.

Ky panair mjedisor, i mbajtur në Modelariumin e Fakultetit të Arkitekturës në Prishtinë, ka paraqitur fotografi dhe video dokumentare, ka prezentuar rezultatet e shumë analizave që OJQ-të tona i kanë bërë, si dhe ka ftuar akterët e involvuar në debat publik, duke tentuar ta shpalos të gjithë eko-logjikën e të përditshmes sonë mjedisore, që vazhdon ta sfidojë politikën kosovare, por edhe secilin nga ne që duhet të jemi shumë më shumë se spektatorë dhe konstataues të gjendjes së rëndë mjedisore që na rrethon. Pjesa e debateve ishte e ndarë në dy pjesë: paneli i paraditës me zyrtarë të qeveris, dhe paneli i pasditës me aktivitet të shoqërisë civile.

Lista e projekteve të organizatave të mbështetura në shtyllën e hapjes së të dhënave dhe sektorit nxjerrës dhe shpenzime tjera:

Emri i Projektit	Grantist	Shuma në Euro
Degradimi i ambientit përmes prokurimit publik për investime kapitale	Instituti Demokratik i Kosoves	25,666.00
Punetori rreth intervenimit qytetar ne degradimin e lumit Lepenc	Operacional	2,972.97
Peticion - Degradimi i Ambientit nga Mini Hidrocentralet	Iniciativa per Progres - INPO	4,995.00
Peticion - Degradimi i Ambientit nga Mini Hidrocentralet	Kosovo Advocacy and Development Center - KADC	4,650.00
Peticion - Degradimi i Ambientit nga Mini Hidrocentralet	Instituti Demokratik i Kosoves – KDI	5,000.00
Peticion - Degradimi i Ambientit nga Mini Hidrocentralet	Reconciliation Empowering Communities – REC Kosova	4,887.50
Peticion - Degradimi i Ambientit nga Mini Hidrocentralet	Ec Ma Ndryshe	3,610.00
Peticion - Degradimi i Ambientit nga Mini Hidrocentralet	Gjethi	3,650.50
Peticion - Degradimi i Ambientit nga Mini Hidrocentralet	Environmentally Responsible Action – ERA	5,000.00
Peticion - Degradimi i Ambientit nga Mini Hidrocentralet	Aktiv	3,810.00
Ekologji(k)a kosovare – panair/debate	Cohu	4,800.00
Deponitë e mbeturinave – problem mjedisor akut	Reconciliation Empowering Communities – REC Kosova	6,000.00
Bashkërendimi i koalicionit “Pro Open” karshi Publish What You Pay	FOL!	15,630.00
Avokim mbi gjendjen e degradimit te lumit Lepenc	Iniciativa per Progres – INPO	9,975.00
	Subtotal	100,646.97
Shpenzime programore		
Publikim dhe printim	Operacional	16,759.91
Shërbime të përkthimit	Operacional	1,293.49
Shpenzime tjera administrative programore	Operacional	10,031.14
	Subtotal	28,084.54
	Total	128,731.51



EDUKIMI I LARTË



EDUKIMI I LARTË

Sfidimi i Korrupcionit në Arsimin e Lartë

Përmbledhje

Viti 2019 barti me vete të njejtat probleme në sektorin e arsimit të lartë: ndikimi i politikës, mungesa e transparencës financiare, integriteti akademik dhe të tjera çështje të cilat nuk janë trajtuar nga institucionet përkatëse e që rrjedhimisht kanë penguar rritjen e cilësisë në arsimin e lartë. Për Fondacionin ishte viti i tretë i realizimit të këtij programi. Fokusi vazhdoj të jetë mbështetja e punës së Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet – KITU, por edhe e organizatave tjera të cilat nuk janë pjesë e koalicionit.

Koalicioni për Integritet dhe Transparencë në Universitet – KITU përbëhet nga këto organizata: Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS-), Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), OJQ Admovere, Demokracia për Zhvillim (D4D), Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED), Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA), Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet, Çohu! dhe Qendra për Kurajo Politike (CPC).

KITU ka vazhduar të publikojë raporte dhe studime me qëllim të përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies brenda sistemit të arsimit të lartë në Kosovë. Përveç publikimeve të shumta me të cilat KITU ka avokuar vazhdimisht, në këtë vit ka organizuar takime dhe punëtori me të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe këto ngjarje kanë për qëllim përafrimin e qëndrimeve dhe identifikimin mundësive të bashkëpunimit për realizimin e qëllimit të përbashkët: rritjes së cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë.

Në qershor është hapur konkursi i cili i ka ftuar organizatat të aplikojnë me projekt propozimet e tyre duke u orientuar në këto dy objektiva: 1. Aktivitete të grupeve studentore dhe stafit akademik të universitetit që avancojnë nivelin e angazhimit të tyre për një universitet më transparent dhe llogaridhënës dhe 2. Punë hulumtuese dhe avokim konkret në vendosjen dhe korrigjimin e masave që luftojnë dukuritë abuzive dhe i hapin rrugë reformave në edukimin e lartë.

Pas shqyrtimit të të gjitha aplikacioneve janë mbështetur organizatat të cilat i kanë përmbushur kriteret e konkursit. Përveç organizatave anëtare të KITU'S janë mbështetur edhe organizata të cilat nuk janë anëtare.

Programi Sfidimi i Korrupcionit në Arsimin e Lartë në vitin 2019 pati dy objektiva kryesore:

1. **KITU – fuqizimi i koalicionit, monitorimi i arsimit të lartë dhe veprimet avokuese**
2. **Përkrahje lëvizjeve studentore që të aftësohen për adresim të transparencës, integritetit dhe llogaridhënies në universitet**

KITU – fuqizimi i koalicionit, monitorimi i arsimit të lartë dhe veprimet avokuese

Odisejë - Universiteti i Prishtinës nëpër vite

Më 13 shkurt 2019, kur ishte 49 vjetori i themelimit të UP-së, KITU organizoi ngjarjen tërëditore “Odisejë – Universiteti i Prishtinës nëpër vite”. Gjatë kësaj dite u hap ekspozitame fotografi, pati prezente, debate dhe mbrëmje muzikore.

Në ekspozitë, nëpërmes fotografive u paraqiten kronologjikisht ngjarjet më të rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar UP-ja përgjatë gati gjysëm shekulli: 1. Te vitet '60 janë prezentuar themelimi i 4 fakulteteve të para, që atëherë ishin degë e Universitetit të Beogradit, pastaj demonstratat e vitit 1968, në të cilat, mes tjerash, ishte kërkuar edhe themelimi i UP-së, pastaj miratimi i ligjit për themelimin e UP-së nga Kuvendi i Kosovës më 1969, e me radhë 2. Në vitet '70, është pasqyruar themelimi i UP-së dhe i fakulteteve tjera në kuadër të UP-së, marrëveshjet e bashkëpunimit me Universitetin e Tiranës, me një fjalë, entuziazmi i jashtëzakonshëm, si nga profesorët, ashtu edhe nga studentët, për themelimin e institucionit më të rëndësishëm - UP-së 3. Tutje, te vitet e '80 janë rrëfyer demonstratat e vitit 1981, pastaj kritikata e para për integritetin akademik në UP, me theks të veçantë për plagjiaturën, të publikuara përgjatë viteve 80 4. Vitet '90 janë vitet e mbijetesës - dëbimi prej godinave universitare nga ana e pushtetit serb, pastaj protestat kundër këtij segregimi e aparteidi, krijimi i Universitetit të Prishtinës nëpër shtëpi private, protestat e 1 tetorit 1997 dhe lufta 5. Pjesa e fundit e ekspozitës ishte pas lufta, ku renditëm kryesisht disa nga skandalet e rektorëve të UP-së, kryesisht të caktuar nga politika 6. Ndërkaq, në ballë të ekspozitës janë vendosur gjetjet kryesore të organizatave të koalicionit KITU për gjendjen aktuale në UP.

Përveç ekspozitës, në këtë ditë u organizua edhe prezentimi i raporteve të hartuara nga anëtarët e KITU-s, me temën *Integritet i sulmuar: sfidimi i kulturës së mos-ndëshkueshmërisë në arsim të lartë*. Pastaj, u organizua një debat me Ministrin e Arsimit, Rektorin e UP-së dhe drejtorin ekzekutiv të KEC-it, me temën *Një kahje e re: Universiteti pas gati gjysmë-shekulli dhe rruga përpara*.

Ky debat më pas u transmetua edhe në televizionin KTV. Në fund të ditës pati mbrëmje muzikore, në të cilën pati shumë studentë dhe profesorë të UP-së, dhe universiteteve tjera në Kosovë si dhe pjesëtarë të shoqërisë civile e gazetarë.

Bashkëpunimi i shoqërisë civile dhe institucioneve të arsimit të lartë – Mundësi për ngritjen e cilësisë

Pas disa vitesh pune e angazhimi, debatesh, publikimesh të gjetjeve të rëndësishme, përfshirje në përmirësimin e infrastrukturës ligjore dhe rregullative të arsimit të lartë, KITU e pamomentin e krijimit të mundësive të reja të bashkëpunimit dhe maksimizimit të realizimit të rekomandimeve të deritashme përmes punës së përbashkët me institucionet relevante të arsimit të lartë. Për këtë arsye në muajin maj KITU ka organizuar punëtori me qëllim të krijimit të urave të shëndosha të komunikimit, përafrimit të qëndrimeve dhe identifikimit të mundësive të bashkëpunimit për realizimin e qëllimit të përbashkët: rritjes së cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë. Në punëtori pjesëmarrës ishin përfaqësues të Rektoratit të Universitetit të Prishtinës, rektori dhe prorektorët, anëtarë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, zyrtarë të arsimit të lartë në MASH-it, anëtarë të Komisionit Parlamentar për Arsim, përfaqësues të Universiteteve Publike, anëtarë të KITU si dhe ekspertë të arsimit të lartë.

Në punëtori janë diskutuar katër tema të përgjithshme. Këto tema diskutimi rodhën nga gjetjet e KITU's përgjatë periudhës dy vjeçare të hulumtimit si: Rritja e transparencës Institucionale, Luftimi i (perceptimit të) politizimit të universiteteve, Menaxhimi i mirë i financave, Rritja e integritetit (akademik) dhe Proceset e sigurimit të cilësisë.

Për të gjitha këto temaanëtarët e KITU janë zotuar të shohin mundësinë e avokimit me qëllim të jetësimit të nevojave të konstatuara për aq sa lejon misioni i OJQ-ve përbrenda kontekstit Kosovar. Në anën tjetër universitetet si dhe institucionet publike relevante të arsimit të lartë (AKA, MASH-it, Komisioni Parlamentar për Arsim) janë zotuar në zbatimin më rigoroz të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi me qëllim të rritjes së transparencës. Këto zotime janë dakorduar nga institucionet dhe KITU: *Institucionet marrin për obligim: 1. Të ftojnë në ngjarje/takimkomisione/grupe pune partnerët*

nga organizatat e shoqërisë civile të përfshira në çështje përkatëse dhe 2. Të ofrohet qasje më e lehtë në informacionin publik të nevojshëm për rritjen e transparencës institucionale. *Ndërsa, KITU merr për obligim: 1. Të ofrojë informacion për hulumtimet e kryera për institucionet përkatëse para se të publikojë materialet me qëllim të evitimit të gabimeve në publikim të rezultateve 2. Të organizojë takime për informim dhe shqyrtim të mundësive të bashkëpunimit të ndërsjellë të paktën një herë në vit 3. Në cilësinë e një agjenti avokimi të krijojë mundësi për hapjen e horizonteve ndërkombëtare të bashkëpunimit 4. Të organizojë një punëtor për detajimin e planit të veprimit lidhur me çështjet e ngritura në këtë takim.*

Agjencioni Kosovar i Akreditimit – AKA

Për t'i kontribuar shtimit të transparencës dhe besueshmërisë së procesit të akreditimit, KITU ka shpeshur gatishmëri që të bëjë monitorimin e punës së Agjencisë. Me 27 mars 2019 është marr vendimi për Marrëveshjen e Mirëkuptimit në mes AKA's dhe KITU's. Kjo marrëveshje saktëson modalitetet e procesit të monitorimit dhe nga ana e KITU's është caktuar Organizata për Ngritjen e Cilësisë në Arsim – ORCA ta bëjë monitorimin e takimeve të këtij agjencioni. Objektivat e këtij Memorandumi janë: 1. Rritja e bashkëpunimit në mes të shoqërisë civile dhe institucioneve publike 2. Rritja e transparencës në procesin e punës dhe qasjes së palëve të treta në mbledhjet e KShC-së 3. Koordinimi i veprimeve ndërmjet KITU dhe KShC lidhur me ngritjen e cilësisë së arsimit të lartë dhe 4. Stimulimi i përmbushjes së standardeve evropiane në fushën e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë.

Në vitin 2018, KITU përmes delegacionit të vet përfaqësues ka vizituar në Bruksel selinë e Regjistrimit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë EQAR-it dhe Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë ENQA-s para se të merrej vendimi për shqyrtimin e statusit të Agjencionit Kosovar për Akreditim,

nga asamblea e përgjithshme e ENQA. Përkundër këtij avokimi, vazhdimi i ndërhyrjeve politike bëri që, më 19 shtator 2019 ENQA të merr vendim që ta përjashtojë AKA-në. Edhe EQAR-i e përjashtoi Agjencinë me arsyetimin se e ka humbur aftësinë për të vepruar si e pavarur.

Disa nga të arriturat e organizatave anëtare të KITU's

Shitja e diplomave – ÇOHU!

Në mars Policia e Kosovës ka arrestuar dy persona nën dyshimin se kanë bërë tema të diplomës për palët tjera. Ky intervenim ka ndodhur pas publikimit të video-dokumentarit të realizuar nga organizata ÇOHU.

Rasti Bektashi

Më 21 shtator 2018, Admoverë publikoi raportin "Stafi akademik i UP-së – studimet, angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerësimet dhe përpjesa staf-studentë". Një prej qëllimeve të këtij raporti ishte edhe radhitja e të gjitha rasteve të plagjiaturave të pjesëtarëve të stafit akademik të UP-së, për të cilat është raportuar në media përgjatë viteve, që nga vetë themelimi i UP-së. Pas publikimit të këtij raporti, më 1 tetor 2018, profesori i Fakulteti i Juridik, z. Mejd Bektashi, ka paditur për shpifje, kurse Gjykata Themelore në Prishtinë më 8 nëntor 2018, aprovoi masën e sigurisë, të kërkuar nga paditësi, me të cilën u detyruam ta tërheqim pjesën e raportit që flet për të, si dhe të mos bëjmë deklaratë në lidhje me personalitetin e tij, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata.

Gjykata e Apelit më datë 28 shkurt 2019 mori Aktvendimin Ac.nr.5022/18 përprishjen e Aktvendimit të Gjykatës Themelore për caktimin e masës së sigurisë, të datës 8 nëntor 2018, dhe e ktheu çështjen në rivendosje te Gjykata Themelore. Gjykata e Apelit gjeti se ankesa e Admoveres është e bazuar dhe konstatoi se Aktvendimi për caktimin e masës

së sigurisë ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, se është bërë zbatimigabuar i të drejtës materiale dhe se nuk është vërtetuar drejt dhe në masë të plotë gjendja faktike.

Më 26 mars dhe 24 prill 2019, u mbajtën seancat për rivendosje në lidhje me kërkesën e z. Bektashi për caktimin e masës së sigurisë në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Si rrjedhojë, më 3 maj 2019 Gjykata Themelore në Prishtinë e refuzoi si të pabazuar propozimin e Mejdii Bektashit për caktimin e masës së sigurisë.

Avansimet– ORCA

ORCA ka raportuar për përmirësimin gradual të gjendjes me justifikimin e titujve në UP. Nga viti 2017, prej kur ka filluar këtë angazhim i ORCA's, numri i profesorëve që e justifikojnë titullin e tyre akademik me punime shkencore është në rritje. Në vitin 2017, 72% e profesorëve nuk e justifikonin titullin e tyre akademik. Në vitin 2018 ORCA sponsorizoi një udhëzim administrative i cili hyri në fuqi nga MASHT. Në vitin 2018 numri i profesorëve që nuk e justifikojnë titullin akademik ka rënë në 59% (megjithatë shqetësues). Rezultatet e hulumtimit të vitit 2019 tregojnë se ky numër ka rënë në 55%. ORCA ka raportuar se 25% e të gjitha punimeve shkencore që nga themelimi i tij, janë publikuar në periudhën 2017-2019, që prej kur ORCA ka filluar programin e vet për monitorim të procesit të avancimeve.

ORCA ka realizuar dy operacione thumbimi të revistave mashtruese. Dy revista, një në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore dhe një në Fakultetin EKonomik, me rekomandim dhe kërkesë të ORCA-s janë përjashtuar nga vet Senati i UP-së si revista që nuk mund të përdoren për avancim në UP.

Në dhjetor KITU ka planifikuar që të mbahet marshi protestues kundër vendimeve të Këshillit të Etikës në UP: **Veting në Arsimin e Lartë!** Në këtë marsh janë ftuar të gjithë qytetarët, studentët, organizatat studentore dhe organizatat e shoqërisë civile të bashkohen në luftën për çirimin e universitetit nga kapja dhe së

bashku të marshohet me kërkesat për: 1. krijimin e komisionit për verifikimin e Plagjiaturave; 2. krijimin e komisionit për verifikimin e titujve akademikë. Për arsye se ndodhi tërmeti në Shqipëri ky marsh u shtye për një kohë më të përshtatshme.

Publikimi **“Profesorët përballë Ligjit”** sjell në vëmendjen e publikut mënyrën se si administrohet drejtësia në rastet kur të dyshuarit, të akuzuarit ose të dënuarit janë pjesëtarë të stafit akademik të Universitetit të Prishtinës, universitetit më të madh publik në vendin tonë. Andaj, raporti i organizatës Admoverenë thelbin e tij përqendrohet në raste konkrete të shkeljeve të ndryshme të kryera prej pjesëtarëve të këtij stafi, si brenda universitetit, ashtu edhe jashtë tij, për të hetuar nëse ato kanë rezultuar me ndonjë pasojë për angazhimin e tyre akademik. Në pjesën e parë të raportit paraqiten rastet kur pjesëtarë të stafit akademik të UP-së dyshohen të kenë shkelur në çfarëdo mënyre Kodin e Etikës të UP-së; kurse në pjesën e dytë, paraqiten raste të përballjeve të stafit akademik me ligjin në Kosovë, që kanë rezultuar me kallëzime penale, aktakuza, ose dënime nëpër institucionet e drejtësisë, qoftë edhe për veprime që nuk lidhen me punën e tyre në UP.

Profesorë të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK) të Universitetit të Prishtinës (UP) patën alarmuar publikisht për rrezikun e mbylljes së programit studimor të elektro energjetikës në këtë fakultet. Duke pasur parasysh se është fjala për profil studimi që nuk ofrohet nga asnjë institucion i lartë arsimor tjetër në Kosovë, dhe pasojat që do të sillte mbyllja e këtij programi studimor për ekonominë dhe industrinë e vendit, në afat të mesëm e të gjatë, Admoverenë është mbështetur që ta publikojë një raport që fokusohet në rrezikun dhe pasojat e mbylljes së programit të elektroenergjetikës në FIEK, Gjendja në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK).

Raporti ka gjithsejt 20 përfundime/gjetje dhe 5 rekomandime për FIEK-un, UP-në, MASHT-in dhe Qeverinë e Kosovës: 1. Dekanati i FIEK-ut dhe

Rektorati i UP-së, me mbështetje nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe nga Ministria e Financave (MF), si dhe nga industria, të ofrojë bursa për studentët e dalluar, si dhe për asistentët e rregullt për studime doktorature në universitete evropiane, me kushtin që pas përfundimit të kthehen për angazhim të rregullt akademik në FIEK. Po ashtu, kuadrove të pranuar në FIEK që janë duke bërë doktoraturën jashtë vendit të mos u shkëputet kontrata e punës.

2. Dekanati i FIEK-ut dhe Rektorati i UP-së, me mbështetje nga MASHT dhe nga MF, të eliminojë pengesat buxhetore në rekrutimin e stafit të ri akademik të rregullt në FIEK për drejtime të veçanta që janë me interes nacional, siç është elektroenergjetika.

3. Të krijohet një mekanizëm nga Dekanati dhe Rektorati që do ta monitoronte gjendjen e stafit akademik nëpër departamente të FIEK-ut, në mënyrë që konkurset për staf të rregullt akademik të shpallen më shpesh e në përputhje me nevojat, jo duke ndjekur praktikën e deritashme të shpalljes së konkurseve gati një herë në dy vjet për të gjitha fakultetet njëherësh. Poashtu, mekanizmi i lartpërmendur të sigurohet që të paktën gjashtë muaj para se të dalë në pension një pjesëtar i stafit të rregullt akademik, të shpallet konkursi ose të nisnin procedurat për avancimin e asistentit të tij/saj.

4. Krijimi i kuadrove merr kohë, prandaj të shikohet mundësia që të doktoruarvetë cilët i plotësojnë kushtet statutore për angazhim të rregullt, e që janë të punësuar në industri, t'u ofrohen incentiva për t'u angazhuar në akademi.

5. Të rritet buxheti për hulumtime shkencore dhe FIEK-u të jetë edhe institucion që gjeneron vetë të ardhura, duke krijuar institute për hulumtime shkencore dhe ekspertiza të ndryshme për ndërmarrje dhe institucione të vendit, në mënyrë që të ketë një lidhshmëri mes universitetit dhe industrisë.

Admovere në vitin 2020 do të vazhdojë me hulumtimin për Shkaktarët dhe pasojat e mbylljes/mos akreditimit të programeve studimore në Fakultetin e Gjeoshkencave në Universitetin e Mitrovicës Isa Boletini.

Nga realizimi i hulumtimit deri më tani, Organizata Çohu gjatë realizimit të projektit **Arsimi Privat në**

Kosovë ka gjetur një numër të madh shkëlqesh. Kolegjet private kanë mungesë të theksuar të stafit. Një pjesë e konsiderueshme e profesorëve që japin mësim në këto kolegje janë staf i Universitetit të Prishtinës. Disa prej tyre nuk e kanë infrastrukturën e nevojshme dhe operojnë në shtëpi private. Një gjë tjetër që është vërejtur gjatë hulumtimit është se studentët në këto kolegje pranohen pa provim pranues dhe pa test të maturës.

Për të akredituar një program, kolegjet duhet të paraqesin bartësit e programit dhe stafin akademik që do të ligjërojë për atë program. Por, Agjencia e Akreditimit të Kosovës, nuk bën monitorime nëse stafi i paraqitur në letër, jep mësim në ato programe apo në vend të tyre ligjëron dikush tjetër. Disa prej kolegjeve private i kanë tejkualuar kuotat e caktuara nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës për pranimin e studentëve dhe Çohu vazhdon të punojë për të siguruar raporte të cilat i kanë evidentuar këto tejkalime. Tejkalimi i kuotave nënkupton se studentët që kanë kryer të gjitha provimet dhe kanë diplomuar, nuk mund ta legjitimojnë diplomën e tyre në MASHT për faktin se ata janë regjistruar jashtë afatit dhe nuk figurojnë në librat amëz apo tashmë në sistemin SMIAL i cili menaxhohet nga MASHT. Deri në vitin 2016 kolegjet nuk kanë pasur fare kuota, pra kanë pranuar studentë aq sa kanë dashur.

Preportr ka shikuar lidhjet politike të profesorëve që punojnë në kolegjet private dhe kanë lidhje me partitë politike. Nga të dhënat e nxjerra rezulton se 15 prej tyre kanë lidhje me politikën: gjashtë nga LDK, pesë PDK, një VV dhe dy nga AAK.

Nga kontrollimi i deritanishëm i rreth 80% të kolegjeve private, rezulton se rreth 60 ligjërues kanë marrëdhënie pune me kolegje private dhe ato publike.

Organizata ÇOHU gjatë vitit 2020 do ta shtrijë fokusin e hulumtimit të kolegjeve private, duke shtjelluar specifikisht dy probleme: 1. Kriteret e pranimit dhe vlerësimit (kalueshmërisë dhe diplomimit) të studentëve në kolegje private dhe 2. Stafi akademik (kuadrot) dhe literatura në

kolegje private.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit **Avokim për avansimin e integritetit akademik dhe cilësisë së arsimit të lartë**, të implementuar nga Qendra për Kurajo Politike, është përmirësimi i politikave dhe dokumenteve kyçe që rregullojnë çështjet e integritetit akademik të UP-së. Në kuadër të projektit është organizuar tryeza në të cilën janë diskutuar të gjeturat dhe rekomandimet e kryesore të raportit Dialog mes të shurdhërve – Mbi integritetin akademik në Universitetin e Prishtinës.

E arritur e projektit konsiderohet prezentimi dhe shpërndarja e raportit të lartëpërmendur me pothuajse të gjitha palët e interesit, fillimi i debatit në lidhje me temat e këtij raporti dhe publikimi i një dokumenti të politikave. Poashtu, në kuadër të këtij projekti i cili do të vazhdojë punën edhe në vitin 2020, janë realizuar tri seminare.

Projekti **Koalicioni për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë** (Coalition for Higher Education Quality Assurance – CHEQA), i implementuar nga Kolegji Ndërkombëtar i Biznesit në Mitrovicë IBC-M ka përqëllim përmirësimin e bashkëpunimit dhe rrjetëzimin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë duke krijuar kështu një model të bashkëveprimit ndërmjet tyre, përmes krijimit të Koalicionit të Institucioneve të Arsimit të Lartë të Kosovës. Koalicioni synon t'i bashkojë institucionet publike dhe ato private për arritjen e një platforme të përbashkët për sigurim të cilësisë. Ky projekt do të vazhdojë punën dhe gjatë vitit 2020.

Tabela e granteve dhe shpenzimeve tjera

Emri i Projektit	Grantist	Shuma në Euro
Odisejë: Universiteti i Prishtinës ndër vite	OJQ Admovere	9,300
Arsimi privat në Kosovë	Organizata për Demokraci, Antikorrupcion dhe Dinjitet - Çohu!	22,600
Avokim për avansimin e integritetit akademik dhe cilësisë në arsim	Qendra perKurajo Politike	17,987
Ngritja dhe rënia e drejtimeve elektro-teknike në UP	OJQ Admovere	15,000
Koalicioni për sigurimin e cilësisë së arsimit të lartë	Kolegji Ndërkombëtar i Biznesit	8,750
Arsimi privat në Kosovë – thellim i hulumtimit	Organizata për Demokraci, Antikorrupcion dhe Dinjitet - Çohu!	24,760
Shkaktarët dhe pasojat e mbylljes/mos akreditimit të programeve studimore në Fakultetin e Gjoshkencave në UMIB	OJQ Admovere	9,820
Konsulencë		2,000
Bashkëpunimi i shoqërisë civile dhe institucioneve të arsimit të lartë – Mundësi për ngritjen e cilësisë – Punëtorja në Tiranë	Operacional	7,338.93
	Subtotal	117,556
Shpenzime tjera programore		
Publikime dhe shtyp		3,978.75
Shërbime përkthimi		959.83
Shpenzime Administrative Programore		10,765.00
	Subtotal	15,703.58
	Total	133,259.58

Përkrahje lëvizjeve studentore që të aftësohen për adresim të transparencës, integritetit dhe llogaridhënies në universitet

Kosova mbetet vendi me ekonominë më pak të zhvilluar në rajon dhe në Evropë. 54% e të rinjve nën 25 vjeç janë të papunë. Ky zhvillim i ulët ekonomik reflektohet në investimet e ulëta në arsim, veçanërisht arsimin e lartë. Investimi i ulët reflektohet më pas në efektivitetin e ulët të masave për të përmirësuar cilësinë e arsimit të lartë.

Universiteti i Prishtinës, në nivelin Bachelor ka gjithsej 33 mijë e 18 studentë, në nivelin Master ka gjithsej 6 mijë e 682 studentë, ndërsa kandidatë të pranuar në studimet e doktoratës ka gjithsej 66. Ndërkaq, Universiteti i Prishtinës, ka gjithsej 930 punonjës akademik të rregullt dhe 452 të angazhuar. Kjo do të thotë se proporcioni profesor student është 1:43, në vendet e rajonit mesatarja është 1:25 ndërkaq në BE 1:8 deri 1:15 varësisht nga fusha e studimit.

Në Kosovë arsimit i lartë shihet si vazhdim i arsimit të mesëm me qëllimin përfundimtar dhe të vetëm për të fituar një diplomë – jo gjithmonë në profile të cilat garantojnë punësim dhe jo gjithmonë me kualifikime dhe kompetenca të nevojshme. Kjo mënyrë joproduktive e të menduarit është përdorur nga disa grupe për përfitime politike duke vendosur gjithnjë e më shumë student në institucionet e arsimit të lartë duke kompromentuar kështu cilësinë e studimeve. Ende vazhdon të mbetet perceptimi publik se organizatat studentore kontrollohen nga partitë politike apo grupe të tjera të interesit.

Projekti i **Integriteti Akademik Përmes Aktivizmit Studentor**, i realizuar nga ORCA ka përfshirë në njërin anë informimin e publikut përmes paraqitjes së gjendjes rreth integritetit akademik dhe shpenzimit e parasë publike në universitete, dhe në anën tjetër në ngritjen e vetëdijes kritikuese tek studentët dhe përfshirjen e tyre në

aksione simbolike.

Rezultatet kryesorë të projektit janë: 1. Rreth 150 studentë të përfshirë aktivisht në projekt dhe në total mbi 340 të përfshirë në të gjitha aktivitetet e vitit 2019. 2. Forcimi i kriterëve për emërimin dhe avancimin e stafit akademik në UP përmes rregullores së re 2/748 të miratuar më 01 tetor 2019. ORCA ka avokuar suksesshëm që punimet shkencore të nevojshme për avancim nga qershori i 2020 të botohen vetëm në revistat e indeksuara në dy databazat indeksuese më prestigjioze Web of Science dhe SCOPUS. Ndërkaq, nga fillimi i vitit 2023 punimet e nevojshme për avancim akademik - pavarësisht vitit të botimit të tyre - do të merren parasysh vetëm nëse janë botuar në revista të indeksuara në dy databazat e përmendura. 3. Zbulimi i skemave të mbinormave dhe stërpaguesave të stafit akademik menaxhues të universiteteve publike në Kosovë. ORCA ka botuar raportin **“Borxhezia’ e Akademisë”** që paraqet pagesat për stafin menaxherial nga universitetet publike, ku del se: rektorët paguhen mesatarisht 2517 Euro në muaj, 46% e kësaj nga pagesat shtesë; dekanët paguhen mesatarisht 2202 Euro në muaj, 43% e kësaj nga pagesat shtesë. Ndërkaq nga të gjitha universitetet publike ka rezultuar që më së shumti paguhen anëtarët e dekanatit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, me pagesa deri në mbi 3500 Euro në muaj. Të dhënat për këtë hulumtim janë marrë nga deklaratimet e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit. 4. Hulumtimi i parë në Kosovë për **“Shportën e Studentit”** që tregon shpenzimet e studentëve përgjatë studimeve duke përfshirë akomodimin, pagesat semestrale, transportin, ushqimin, rekreacionin etj., ka treguar se studentët e UP-së shpenzojnë mesatarisht 150 Euro në muaj. ORCA ka organizuar Kongresin e Aktivizmit Studentorë. Në këtë kongres morrën pjesë më shumë se 50 studentë nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Studentët kanë përfituar njohuri nga aktivistët e shoqërisë civile në Kosovë dhe rajon. Në këtë kongres u propozua rezoluta përmes së cilës janë ftuar studentët nga të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor t’i bashkohen kësaj lëvizjeje të re rajonale përmes iniciativës **“Studentët për Cilësi në Arsim 2020”**.

Kjo lëvizje ka për qëllim fuqizimin e cilësisë në arsimin publik.

Klubet e Etikës, është projekt i cili do të realizohet deri në mars 2020. Projekti synon të krijojë grupe burimore të studentëve të cilat problematizojnë çështje që adresojnë më thellë cilësinë e studimeve. Këto grupe të themeluara në secilin fakultet të Universitetit të Prishtinës do të pajisen me njohuri dhe plan të veprimit nga ORCA, me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëria e funksionimit të tyre. Projekti po ashtu synon të botojë numrin e tetë të gazetës satirike-kritike “TEMPULLI I DIJES” që ka si autorë studentët dhe aktivistët e ORCA-s.

Gjatë shtatorit 2019, **Debate Center** ka hapur aplikimin për pjesëmarrje në Debate UP dhe deri në mes të muajit tetor, janë organizuar 10 takime informuese në fakultetet e ndryshme të Universitetit të Prishtinës. Në këto takime janë targetuar rreth 400 studentë. Pas përfundimit të fazës së aplikimit, Debate Center ka pranuar 261 aplikime dhe ka përzgjedhur gjithsej 100 studentë për tu ndarë në tri grupe të debatit dhe janë themeluar klubet në Fakultetin Filozofik, Fakultetin Ekonomik, dhe në Fakultetin e Edukimit. Gjithashtu, janë përzgjedhur 10 profesorë të cilët angazhohen si mentorë të debatit në temat e caktuara. Këto klube kanë mbajtur takime javore (trajnim fillestar deri tek trajnimi i avancuar), dhe janë trajnuar në bazat e argumentimit, fjalimit publik dhe janë informuar më qartë për formatin e debatit British Parliamentary Debate. Në periudhën e njejtë, Debate Center ka mbajtur gjithsej 1,890 orë trajnimi në 21 sesione të trajnimit në total. Në nëntor, çdo grup ka mbajtur 4 trajnime, ndërsa në dhjetor i kanë mbajtur nga 3 trajnime. Projekti do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2020.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit **“Mendo globalisht, vepro lokalisht: Seri e seminareve mbi mendimin kritik dhe integritetin akademik”** ishte ngritja e vetëdijes së studentëve dhe zgjerimi i horizonteve të tyre për cilësinë që do të duhej të ofronin institucionet e arsimit të lartë në Kosovë.

Ky projekt i implementuar nga Qendra për Kurajo Politike ka pasur dy objektiva kryesore: 1. Nxitjen e mendimit kritik përmes debatit konstruktiv mbi integritetin akademik, aktivizmin studentor; dhe 2. Stimulimi i studentëve për organizim më të mirë dhe ringjallje e jetës studentore. E arritur e projektit konsiderohet ngritja e njohurive të studentëve lidhur me temat të cilat ata nuk kanë pasur rast t’i hasin në institucionet ku studiojnë. Tema të rëndësishme për studentë si mendim kritik, integritet akademik, aktivizmi studentor/ qytetar, shkathtësitë e butaqë janë kyçe për sfidat dhe mundësitë gjatë dhe pas studimeve. Në kuadër të këtij projekti është krijuar një rrjet i studentëve të cilët janë duke u motivuar për ngritjen e aktivizmit studentor dhe ringjalljen e jetës studentore.

Projekti **Aftësim profesional në BONEVET** Prishtina synon që të ofrojë një ambient të punës për studentë të Universitetit të Prishtinës nga departamentet e Inxhinierisë Mekanike dhe Elektrike, në mënyrë që ata të zhvillojnë aftësitë e tyre praktike dhe të përgatiten për tregun e punës. Duke filluar nga shtatori, 2019 BONEVET Prishtina ka trajnuar 32 studentë në fushën e Elektronikës dhe CNC Mekanikës duke mbajtur katër trajnime dy mujore (tre në mekanikë dhe një në elektronikë). Të interesuarit për të marrë pjesë në këto trajnime u janë nënshtruar procesit të aplikimit, në të cilin kanë aplikuar 192 studentë.

Ky projekt do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2020. Gjatë muajve në vijim, BONEVET do të vazhdojë edhe me dy trajnime në elektronikë dhe tri trajnime në gjuhën programuese Python.

Tabela e granteve dhe shpenzimeve tjera

Emri i Projektit	Grantist	Shuma në Euro
Mendo globalisht, vepro lokalisht: seri e seminareve mbi mendimin kritik dhe integritetin akademik	Qendra për Kurajo Politike	15,362.01
Integriteti akademik përmes aktivizmit studentor	Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim - ORCA	46,790
Debate UP	Debate Center	16,185
Aftësim profesional në Bonevet Prishtina	Fondacioni Bonevet	15,610
Klubet e Etikës	Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim - ORCA	9,980
Kongresi i Studentëve	Operacional	4,500
	Subtotal	108,427
Shpenzime operacionale programore		
Takimi i Fondacioneve të Ballkanit Perëndimor		892.25
Retreat – Stafi dhe Bordi		1,724.60
	Subtotal	2,616.85
	Total	111,043.85
	GRAND TOTAL I PROGRAMIT	244,303.43



RILIDHJA E MITROVICËS



RILIDHJA E MITROVICËS

Konteksti politik

Në vitin 2019 kishte shume lëvizje politike që e sollën në plan të parë Mitrovicën dhe vendbanimet tjera ku jetojnë serbët. Ky komunitet etnik vazhdon të jetë shumë pak i integruar në shoqërinë Kosovare, edhe pse në disa fusha ka përparime të dukshme. Kurdo që afrohen momentet politike që shihen të një rëndësie të madhe për ardhmërinë e këtij komuniteti, entuziazmi për bashkëpunim dhe për tu integruar në një hapësirë të gjerë civile në Kosovë, bie dukshëm.

Ideja e shkëmbimit të territoreve, korigjimit të kufijve që si rezultat do të kishte edhe lëvizje të popullsisë nga njëra anë në tjetrën, nga Kosova në Serbi dhe anasjelltas, destabilizoj komunitetin serb po aq sa edhe atë shqiptar dhe ngriti një varg pyetjesh dhe dilemash në mesin e tyre. Disa nga frikët kryesore të serbëve të Kosovës që lindën pas kësaj ideje lidhen me braktisjen e tyre nga Beogradi dhe ndërprerja e shërbimeve që ju ofrohen përmes institucioneve të Beogradit, ndërsa të drejtat e tyre kushtetuese supozohet se do të minimizoheshin në krahasim me ato që i gëzojnë tani. Por frika më e madhe e tyre ishte lëvizja e madhe e popullsisë e cila do të ndodhte me një zgjidhje të tillë.

Dialogu i munguar në mes të serbëve të veriut dhe jugut dhe serbëve dhe shqiptarëve të kombinuara me sfidat politike të dialogut Kosovë-Serbi përkeqësuan marrëdhëniet tradicionalisht të brishta, prandaj intervenimi në këtë fushë, dialogut ndëretnik, ishte me se i domosdoshëm.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare ishin edhe një sfidë dhe mundësi për komunitetin serb në Kosovë. Edhe pse zgjedhjet ishin të pritura komuniteti autokton serb nuk arriti të organizohej dhe të siguroj pluralizëm, liri të shprehjes dhe të zgjedhjes në pjesët e banuar me serb. Këto zgjedhje në pjesët e banuara me Serb u cilësuan

nga të gjitha organizatat ndërkombëtare si jo demokratike.

Ky vit solli tentativa të shumta për të filluar dialogu i shumëpritur Kosovë-Serbi të cilat nuk mbeten pa një angazhim të shtuar të fondacionit dhe partnerëve të tij për ta lehtësuar një iniciativë të tillë. Shoqëria civile serbe ishte aktive dhe jo patjetër e ngurtë kur e adresoi këtë perspektivë politike në shumë ngjarje që u organizuan në qendrat e themeluara nga fondacioni (CEC) nga partneret tanë. Kjo perspektivë e bashkëpunimit është trajtuar edhe në takime gjithëpërfshirëse të përfaqësuesve më të dalluar të shoqërisë civile serbe, OJQ-të, Mediat, akademikët nga fakultetet në Mitrovicë etj.

Ambienti politik është gjithnjë e më shumë duke u zgjeruar me pjesëmarrjen aktive të organizatave civile dhe mediat serbe, të cilat janë duke sjellë një mendim autokton dhe nganjëherë më ndryshe nga ai i partive politike të cilat janë vetëm një dorë e zgjatur e qeverisë në Beograd. Guximi për një mendim politik ndryshe nga “establishmentit” është në rritje dhe në raport të drejtë me tentativat e bashkëpunimit me pjesëtar të shoqërisë civile shqiptare, që dëshmohet me diskutime shumë frytdhënëse që pjesëtarët e këtyre dy komuniteteve i realizojnë në TV-projektin e fondacionit “SporaZoom”, Klubet sociale, diskutimet e shumta të organizatave tjera të përkrahura nga Fondacioni dhe donatorët tjerë që organizohen në këto qendra. Pjesëmarrja e shoqërisë civile serbe në proceset politike të Kosovës këtë vit ishte më e dukshme se në vitet e kaluara që u dëshmuar edhe me një numër të prezantimeve dhe diskutimeve të qëndrimeve të tyre karshi proceseve aktuale politike që u organizuan në Prishtinë me panele të përziera.

Përmbledhje – qëllimi dhe objektivat

Në vitin 2019 programi Reconnecting Mitrovica ka zgjeruar shtrirjen e vet në një masë më të madhe edhe në pjesët tjera të banuara me serbë përveç veriut, kryesisht në Kosovën qendrore, në Graçanicë dhe rrethinë. Gjithashtu, programi këtë vit pati një shtesë buxhetore të ndarë nga OSF si shtesë e njëhershme me të cilën duhej të adresoheshin sfidat e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Shtrirja e programit në pjesët tjera të Kosovës, përveç veriut, erdhi si rezultat i nevojës për të lidhur serbët nga të dyja anët e lumit Ibër me qëllim që ky komunitet në tërësi së pari të rilidhet në mes veti për të shpalosur nevojat dhe qëndrimet e tyre, që shpeshherë për shkak të realiteteve në të cilat jetojnë janë të ndryshme dhe më pas me qëndrime të unifikuara të dalin para përfaqësuesve të tyre politik dhe qeverisë së Kosovës për të shprehur nevojat e veta karshi politikave qeveritare në përbushjen e të drejtave të pakicave dhe njëkohësisht të shprehin shqetësimet apo propozimet e veta lidhur me rrjedhën e procesit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Sfidat kryesore gjatë vitit 2019 në konceptin “Rilidhja e Mitrovicës” ishin (1) zhvillimi dhe fuqizimi i më tejme i punës së Qendrave të Energjisë Qytetare në Mitrovicë dhe Graçanicë me çka forcohet debati i serbëve në mes veti, diskutimi ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve dhe kultivohet kultura e debatit si mjet për adresim të problemeve të grumbulluara, (2) adresimi i dialogut Kosovë-Serbi, nga prizmi serb, në kohën kur dialogu ishte plotësisht i ndërprerë dhe pritej të rifillonte në ndonjë format ende të papërcaktuar, ndërsa serbët ishin plotësisht të papërgatitur dhe u zgjuan nga gjumi njëzet vjeçar, për sa ia patën lënë fatin e vet Beogradit, tek pas idesë së “shkëmbimit të territoreve”, dhe (3) inkurajimi dhe zhvillimi i mëtejme i organizatave, koalicioneve dhe platformave avokuese serbe për të avokuar për çështjet të cilat ata i shohin me rëndësi të veçantë për komunitetin e vet që do

të mundësonte integrim sa më të lehtë të tyre në shoqërinë kosovare.

Koncepti “Rilidhja e Mitrovica” gjatë vitit 2019 nuk pati nevojë për adaptime të shumta programore karshi zhvillimeve të reja në komunitet dhe shoqëri si pasojë e politikës ditore dhe dialogut Kosovë-Serbi, as për ndryshim të objektivave të vendosur dhe ishte plotësisht i përgatitur me mekanizmat dhe platformat programore të zhvilluar me herët që të adresoj të gjitha sfidat që dalin nga qëllimi i tij:

Rilidhja graduale e qytetarëve të tjetërsuar të Veriut me pjesët tjera të Kosovës, duke ringjallur shoqërinë civile dhe grupet tjera qytetare serbe të Veriut (të rinjtë, academia, bizneset, etj.), duke lehtësuar komunikimin ndëretnik rreth çështjeve/sfidave të përbashkëta dhe duke e sjellë qytetarin serb më afër shoqërisë dhe institucioneve të Kosovës.

Në vazhdim jepen informata më të detajuara mbi të gjitha aktivitetet e zhvilluara përbrenda konceptit Rilidhja e Mitrovicës të ndarë sipas shtyllave kryesore të intervenimit.

Nxitja dhe lehtësimi i dialogut në mes të serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës

Nxitja dhe lehtësimi i dialogut, edhe pse synim i tërë konceptit dhe i shpërndarë nëpër të gjitha shtyllat programore, ishte në shënjestër të platformave diskutuese të realizuara në Qendrat e Energjisë Qytetare (CEC) Mitrovicë dhe Graçanicë.

Sipas modelit të Qendrës së Energjisë Qytetare (CEC) në Mitrovicë të vendosur në 2015, në vitin 2019 u hap qendra me po të njëjtin emër dhe qëllim, të nxitjes së kulturës së debatit dhe diskutimit përbrenda komunitetit dhe në mes të komuniteteve, edhe në Graçanicë. Të dy qendrat si synime të para kishin mobilizimin dhe ringjalljen e shoqërisë civile serbe që të adresojnë sfidat me

të cilat përballen, nxitjen e debatit dhe diskutimit dhe krijimin e kushteve për ndërveprim me komunitetet dhe grupet e ndryshme të interesit.

Qendra e energjisë qytetare (CEC) në Graçanicë u hap në maj 2019. Përgjegjësinë për menaxhim të përditshëm të saj e ka organizata FDMC, ndërsa programet zhvillohen nga kjo organizatë dhe dy organizata tjera që kanë prezencë dhe reputacion të gjatë në regjionin e Graçanicës, Qendra për paqe dhe tolerancë (CPT) dhe Komunikimi për zhvillim social (CSD). Përveç këtyre tri organizatave qendra është e hapur për të gjitha organizatat dhe grupet civile dhe aktivitetet e tyre.

Programet të cilat me përkrahje të fondacionit zhvillohen në të dy qendrat (CEC) janë të formatizuar ashtu që të i përshtaten komuniteteve të cilave iu shërbejnë dhe të kenë ndërlidhje në mes veti. Dy programet kryesore që zbatohen në të dy CEC qendrat janë: 1) Klubet sociale (i Mitrovicës dhe i Graçanicës), 2) Emisioni “SporaZoom” dhe 3) shfrytëzimi i hapësirës nga organizatat tjera të financuara nga fondacioni apo donatorët tjerë për zbatim të iniciativave të tyre. Programet tjera që zbatohen nga NGO Aktiv dhe FDMC u dizajnuan në bashkëpunim me ata sipas specifikave të secilit rajon dhe komuniteteve të cilat jetojnë në të.

Suksesi i CEC qendrave konfirmohet me numrin e aktiviteve dhe të pjesëmarrësve në ato. Kështu gjatë vitit 2019 në CEC Mitrovica u organizuan 144 ngjarje civile me pjesëmarrje të 2.547 pjesëmarrës ndërsa në CEC Graçanica nga maji deri në fund të vitit u organizuan 124 ngjatje me pjesëmarrje të 2.125 përfitues. Ngjarjet e organizuara janë prej më të ndryshmeve dhe i dedikoheshin grupeve të ndryshme të qytetarëve dhe të interesit prej institucioneve lokale, organizatave të shoqërisë civile, nxënësve të shkollave të mesme dhe fillore e deri te organizatat kulturore dhe të mediave. Këto qendra qe gjashtë vjet janë epiqendra të ngjarjeve civile, të njohura për debate e diskutim të hapur në tema të nxehta shoqërore e politike të cilat ofrojnë hapësirë për pluralizëm të mendimit dhe shprehjes.

Emisioni “SporaZoom”, si produkti më i dukshëm i konceptit në publikë, realizohet në partneritet me tri organizata, NGO Aktiv, FDMC dhe TV Mreza (rrejt i pesë televizioneve dhe një produksion serbe). Këtij partneriteti i bashkëngjitet edhe konsulenti i mediave i angazhuar nga fondacioni për të siguruar cilësinë e emisionit dhe njëkohësisht të zhvilloj kapacitetet e partnerëve përgjatë procesit të realizimit të emisionit. Emisioni menaxhohet nga këshilli editorial i përbërë nga pesë anëtarë, nga një prej secilës organizatë partnere, konsulenti i mediave i fondacionit dhe koordinatorit të programit si anëtarë ex-officio. Deri në vitin 2019 emisioni është realizuar në studion e CEC Mitrovica, ndërsa me vendosjen e CEC Graçanica ky emision realizohet edhe në këtë lokacion sipas orarit të marrëveshjes në mes të partnerëve dhe situatës në terren e cila edhe më tej është mjaft fluide dhe herë pas here e bënë të pamundur xhirimin e emisionit në CEC Mitrovicë.

Gjatë vitit 2019 janë realizuar tetëmbëdhjetë (18) emisione të rregullta dhe një emision special si rekapitullim i tërë vitit i cili është transmetuar me 1 janar, 2020. Emisioni transmetohet në katër TV stacionet serbe, anëtare të TV Mreza (TV Puls, TV Herc, TV Mir), dhe RTV Kim i cili nuk është anëtarë i rrjetit. TV Puls dhe TV Kim janë kanale të cilat janë të përfshira në platformat kablore, IPKO dhe Kujtese dhe mund të shihen në tërë Kosovës. TV Mir siguron mbulimin e Veriut të Kosovës me emision. Emisioni ka edhe kanal in e vet në Youtube, Facebook, Twitter, Instagram dhe të gjitha emisionet vendosen menjëherë pas transmetimit të parë në të gjitha rrejtët sociale.

Formati i emisionit është konceptuar ashtu që gjithnjë të ketë tre mysafire, të bazohet në një analizë apo studim, sipas mundësisë të realizuar nga ndonjë organizatë serbe e Kosovës, një reportazh e shkurtër apo deklaratë mbi temën e diskutuar në studio. Në studio në Mitrovicë kemi edhe tribunat për publikun e cila e përcjellë diskutimin në studio dhe merr pjesë në emision në dy mënyra, duke shërbyer si adhoc fokus grup për temën e cila diskutohet dhe duke i bërë pyetje mysafirëve në studio apo duke komentuar mbi atë

që është thënë më herët. Emisioni “SporaZoom” është emision unik kryesisht sepse është i vetmi në Kosovës i cili sjellë serb e shqiptarë për të diskutuar mbi tema me interes për të dyja palët, vend ku lirshëm dhe pa cenzurë mund të shprehen mendimet e njëjës apo palës tjetër dhe ku debati është i balancuar në të gjitha aspektet të cilat i kërkon një emision i cili pretendon të jetë i paanshëm dhe i hapur ndaj qëndrimeve të ndryshme mbi temat e nxehta dhe të ndjeshme politike të Kosovës dhe rajonit.

Gjatë vitit 2019 janë trajtuar kryesisht tema të cilat kishin të bënin me dialogun Kosovë-Serbi, procesin e integritimit evropian të Kosovës duke e krahasuar atë me proceset në vendet e rajonit, zgjedhjet e parakohshme në Kosovë, kthimin e komuniteteve, gjyqin për krime lufte në Kosovë, etj. por temë dominate ishte dialogu Kosovë-Serbi dhe normalizimi i marrëdhënieve në mes të këtyre dy shteteve. Në emision si mysafirë morën pjesë analistë, gazetarë, ekspertë, përfaqësues të organizatave civile të cilat merren kryesisht me ndonjë teme specifike që trajtohej në emision, etj. Disa nga emrat e mirënjohur të mysafirëve janë: Agron Bajrami, Belul Beqaj, Veton Surroi, Bodo Weber, Adriatik Kelmendi, Stefan Surlic, Djordje Vlajic, Dalibor Jeftic, Mytahir Haskuka, Aleksandar Corac, Luan Shllaku, Gjeraqina Tuhina, Branimir Stojanovic, Miodrag Milicevic, Augustin Palokaj, etj.

Klubet Sociale janë në lloj platforme tjetër e diskutimit të cilat realizohen në CEC qendrat me përkrahje të fondacionit por edhe të donatorëve tjerë ku në atmosferë joformale u trajtuan tema që brengosin qytetarin, prej temave politike e deri te temat kulturore dhe shoqërore të cilat deri vonë mungonin në të dy mjediset ku CEC qendrat u vendosën. Këto klube janë shndërruar në vend takim qytetarësh konstruktiv – të cilat mund të shihen edhe si Rick’sCaffe i Casablankës – vendtakim unik për të gjitha aktivitetet civile në qytet dhe më gjerë dhe vend për diskutim të temave të ndryshme që brengosin qytetarët në veçanti të rinjtë. Koncepti i klubit social të Mitrovicës deri në vitin 2019 kishte një format

më të lehtë të bisedimit në një ambient jo formal (në caffee shop), me muzikë në prapa vijë gjë që nuk pengonte të bisedohet për tema serioze. Zakonisht çdo klub social kishte dy deri ne tre mysafire të cilën në këtë ambient zhvillonin bisedë në mes veti dhe me publikun. Ky koncepti i klubit social në Mitrovicë pati shumë sukses dhe u bart edhe në qendrën në Graçanicë me modifikime të cilat iu përshtatën rajonit dhe grupeve të ndryshme të interesit sipas eksperiencës dhe ekspertizës së organizatave partnere. Këtë vit përmes partnerëve tanë filluam edhe me aktivitet të cilat më herët nuk ishin tipike për klubet ashtu si ishin deri në vitin 2019. Risia në këtë klube ishin kuizet për të rinj, netët e arteve të ndryshme të cilat synon ndryshim shoqërorë, si netët e filmit, fotografisë, karikaturës, muzikës, poezisë e literaturës në përgjithësi që të gjitha me angazhim për një shoqëri më demokratike dhe të hapur. Klubet sociale në CEC Graçanicë përfshinë edhe aktivitete për moshat më të reja si fëmijët e shkollave fillore të cilët përmes aktiviteteve u inkurajoheshin të lexojnë më shumë dhe literaturë më kualitative, përmes filmave që shikonin u nxitën të debatojnë dhe në këtë mënyre u ndikua në fillet e të menduarit kritik. Një risi tjetër që u fut në këtë koncept ishin kafet me ambasadorët i cili ishte shumë i mirëpritur. Për këto takime me ambasadorë gjithnjë kërkohej edhe një vend më shumë në publikë. Temat serioze shoqërore e politike nuk munguan por u vërejt se aktivitetet më të lehta si kuizet e netët e kulturës ndikuan që edhe bisedat politike të kenë një numër shumë më të madh të publikut dhe interesim nga qytetarët. Për të siguruar një përfshirje më të madhe të qytetarëve nga ky vit u fillua edhe me transmetim live përmes Facebook, dhe mjeteve tjera në dispozicion të mediave sociale.

Gjatë vitit 2019 janë realizuar gjithsejtë 39 klube sociale prej të cilave 21 klube sociale në CEC Graçanicë prej të cilave 6 të realizuara nga FDMC, 4 CPT dhe 11 CSD, ndërsa ne CEC Mitrovica janë realizuar gjithsejtë 18 klube sociale prej të cilave 8 ishin diskutime mbi tema shoqërore dhe politike, 5 ishin aktivitete të artit të angazhuar për ndryshim të shoqërisë, 1 kafe me ambasadorë dhe 4 pubkuize.

Lista e granteve dhe shpenzimeve tjera:

Emri i Projektit/iniciativës	Grant marrësi	Shuma në Euro
Vendosja dhe vënia në funksion e Qendrës së Energjisë Qytetare në Graçanicë	Forum për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik (FDMC)	42,629
Qendra e Energjisë Qytetare Mitrovicë – shpenzimet operacionale për mirëmbajtje, qeverisje dhe organizim të aktiviteteve	NGO Aktiv	19,550
Realizimi i 16 emisioneve “SporaZoom”	TV Mreza	32,000
Realizimi i 10 emisioneve “SporaZoom”	NGO Aktiv	15,750
Realizimi i 6 emisioneve “SporaZoom”	Forum për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik	14,683
Qendra e Energjisë Qytetare Graçanicë: Animimi i shoqërisë	Qendra për Paqe dhe Tolerancë (CPT)	11,855
Qendra e Energjisë Qytetare Graçanicë: Zgjimi i shoqërisë	Komunikimi për Zhvillim të Shoqërisë (CSD)	10,630
Klubi social Mitrovica	NGO Aktiv	16,550
Bisede dhe lexim i veprave letrare bashkëkohore me shkrimtarë nga rajoni	Qendra Multimedia	1,500
Realizimi i 1 emisioni “SporaZoom”	TV Mreza	1,870
Subtotali		167,017
Shpenzime programore dhe administrative		
Konsulencë për emisionin “SporaZoom”	Operacionale	9,900
Shpenzime të printimit	Operacionale	1,500
Shpenzime të përkthimit	Operacionale	1,000
Shpenzime tjera administrative	Operacionale	5,306.60
Subtotali		17,706.60
Totali		184,723.60

Përfshirja dhe angazhimi më i madh i OShC-ve dhe mediave të komunitetit Serb në proceset politike dhe shoqërore të Kosovës përmes punës kërkimore dhe avokimit

Kjo shtyllë programore zbatohet kryesisht përmes konkursit të hapur me kritere shumë specifike për OShC-të dhe mediat serbe duke inkurajuar bashkëpunimin me komunitetet tjera, kryesisht shqiptare. Skema e këtij konkursi është vendosur para 4 vjetëve me qëllim që puna e OShC-ve të jetë sa më transparente dhe të përfshijë sa më shumë qytetare. Ky qëllim u arrit përmes përfshirjes së mediave nëpër projektet e përkrahura, gjë që ishte një prej kushteve kryesore të konkursit. Mediat në këto projekte nuk patën rol pasivë të vetëm raportimit të ngjarjeve nga projektet por ishin të kyçur direkt në zbatim të projekteve duke u marrë në masë të madhe edhe punë kërkimore, duke realizuar reportazhe informative mbi çështjet që trajtohen me projekt, realizuar debate televizive dhe të radios, video spote, animacione informative dhe të natyrës avokuese.

Objektivi kryesor i fondacionit me këtë konkurs ishte që t'i adresojë tri çështje që lehtë përkthehen në vlera të pakontestueshme të kësaj shtylle programore: (1) të mbërthehet një spektër të gjerë të organizatave (OSHC-ve dhe media) me ndikim jo të vogël në shoqëri, (2) të zgjerohet spektri i hulumtuesve në projektet e OShC-ve duke i shtuar edhe hulumtuesit e mediave (gazetarët) dhe (3) të forcohet dukshëm kapaciteti avokues i këtyre organizatave në komunikimin e rezultateve me vendimmarrësit.

Fushat e parapërcaktuara të konkursit për të cilat u ftuan organizatat të aplikojnë për vitin 2019 ishin: Marrëveshja e Brukselit dhe procesi i normalizimit të marrëdhënieve Kosovë-Serbi, zhvillimi i qëndrueshëm dhe mbrojtja e ambientit, transparenca dhe llogaridhënia e vetëqeverisjeve lokale, dhe vendosja e komunikimit ndërmjet komuniteteve përmes artit dhe kulturës.

Këtë vit nga 17 projekte me të cilat konkurruan OShC-të me më shumë se 20 partner medial u përkrahën 10 sosh. Nga projektet e përkrahura dolën 6 studime/analiza të cilat u prezantuan në 8 tryeza diskutimi, deri më tani 3 prej tyre u përdorën për realizim të emisionit "SporaZoom", ndërsa u realizuan 16 diskutime televizive dhe 19 në radio, produktet të tjera multimediale të cilat u prodhuan dhe përdorën si nëpër televizione, portale, radio dhe rrjete sociale ishin të panumërta.

Këto projekte si çdo vite më herët nxitën debatin publikë, ngjallën skenën publike në Kosovë duke mos lënë indiferentë edhe publikun shumicë gjë që edhe ishte qëllimi primarë i kësaj shtylle programore.

Ndër projektet më të spikatura ishte ai i matjes së opinionit publik të komunitetit serb në Kosovë **Analiza e trendëve 2019** të cilin e realizoj NGO Aktiv në bashkëpunim me RTV Kim. Kjo analizë realizohet që nga viti 2015 nga NGO Aktiv. Në atë kohë kjo iniciative u nisë si nevojë programore e fondacionit për të matur progresin e integritit të komunitetit serb dhe opinionet e tyre karshi proceseve dhe akterëve kryesorë që i udhëheqin ato. Që nga atëherë kjo analizë është shndërruar në analizë vjetore e cila tani është bërë pikë referente për politikë bërësit, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues politik dhe publikun në përgjithësi për atë se çka po ndodh në ambientin e komuniteti serb të Kosovës. Specifika e këtij viti ishte se këtë vit me analizë u përfshinë të gjitha mjediset ku komuniteti serb jeton në tërë Kosovën ndërsa edicionet paraprake shtriheshin vetëm në veri të Kosovës. Analiza e trendëve 2019 zgjoi shumë interesim jo vetëm në Kosovë por edhe në Serbi dhe rajon.

Empirika, koalicioni joformal i organizatave dhe mediaveserbetë Kosovës këtë vitin kishin duart plotë punë. Kjo platformë u dizajnuar duke marrë për bazë Forumin 2015 të fondacionit dhe pati rrjedhën e vet të formimit dhe transformimit gjatë viteve të ekzistencës së vet. Ajo tash është një mjet i fuqishëm avokimi i komunitetit serb të Kosovës

dhe përbëhet prej 11 OShC-ve dhe 1 mediumi nga të dyja anët e lumit Ibër. Gjatë viteve të veprimit të saj ata realizuan 14 fushata avokuese prej të cilave dy ndodhën këtë vit, 7 letra të hapura mbi proceset e ndryshme politike dhe sociale dhe tash më me rregull kontribuojnë në “Country report” të BE-së.

Nëpërmes të platformës avokuese Empirika janë adresuar çështjet e nxehta politike. Ky instrument i fuqishëm i drejtuar nga partnerët tanë OJQ Aktiv nga Mitrovica, ka sjellë shumë tema, të rënda për diskutim në dukje, por shumë të nevojshme për t’i krijuar shoqërisë civile hapësirë për t’u angazhuar në çështjet aktuale si Negociatat Kosovë-Serbi, implementimi i marrëveshjeve të (mos) arritura deri tash, integrimi në sistem administrativ të Kosovës, Asociacioni i komunave me shumicë Serbe, etj.

Një tjetër fushatë avokuese e cila u realizua në formë operacionale e në bashkëpunim me Empirikën u realizuar në prag të zgjedhjeve parlamentare të Kosovës. Për këtë qëllim Empirika prodhoi një dokument të politikës së shkurtë i cili adresojë interesat kyç për serbët e Kosovës që i drejtohen vendimmarrësve të nivelit qendror. Ky dokument u prodhua dhe prezantua me intencë që të ngritët vetëdija për këto interesat e trajtuar në dokument dhe për të bërë presion të fuqishëm në akterët politik dhe shoqëror që këto interesa ti çojnë përpara deri në zgjidhjen e tyre. Ky dokument trajtoi një varg çështjesh si **interesat kryesorë të serbëve të Kosovës** i cili shërben si pikë nisje për analiza dhe dokumente tjera politike të cilat do të shërbejnë për avokim në vitet në vijim. Për hartim të dokumentit u realizua një fokus grup dhe studime e analiza të hartuara nga organizatat antare të koalicionit Empirika. Dokumenti përpos prezantimit në mjediset e banuara me serbë u prezantua edhe me 5 tetor, 2019 në Prishtinë.

Lista e granteve dhe shpenzimeve tjera:

Emri i Projektit/iniciativës	Grant marrësi	Shuma në Euro
Fuqizimi i transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje në nivelin lokal në Veri të Mitrovicës	Qendra për avokim të kulturës demokratike (ACDC)	8,000
Analiza e trendëve – hulumtim mbi opinionin publik të komunitetit serb në Kosovë – 2019	NGO Aktiv	9,458
Qytetarët kërkojnë zgjidhje	Qendra për të drejtat e komuniteteve pakicë	5,000
Sa janë institucionet e vetëqeverisjes lokale të hapura për qytetarët?	Bota bardh e zi	9,000
ARTvizm - lidhja e komuniteteve përmes artit dhe kulturës	Link	14,862
Ndikimi i problemeve ekologjike në transformim dhe zhvillim të ambientit dhe shoqërisë	Grupi i ekspertëve mjekësorë dhe mjedisorë (EMEG)	9,030
Përmirësimi i pozitës së të rinjve në hijen e marrëveshjes së Brukselit	Sinergija	7,500
Turizmi i qëndrueshëm në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm	Instituti për zhvillim ekonomik territorial (InTER)	9,000
Kosova – Veri, Jug, Lindje, Perëndim	Media Qendra	6,000
Demaskimi i demarkacionit përgjatë linjave etnike: Përparësitë dhe pasojat	Iniciativa e re sociale (NSI)	9,000
Interesat kyç të komunitetit serb në Kosovë – zgjedhjet parlamentare 2019	Operacionale	2,784
Përkrahje për zgjerimin e anëtarësisë së KMSHk nga radhët e komuniteteve joshqiptare	Këshilli i mediave të Shkruara të Kosovës	3,500
Përkrahje për realizimin e filmit dokumentarë mbi jetën dhe veprën e Bekim Fehmiut	Fondacioni Bekim Fehmiu	
Asistencë emergjente humanitare për realizimin e projektit ideorë për ndërtimin e banimit social për romët e goditur nga tërmeti në Tiranë	Zëri i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve	2,525
Subtotali:		100,656
Shpenzime programore dhe administrative		
Shpenzime të printimit	Operacionale	3,000
Shpenzime të përkthimit	Operacionale	304
Shpenzime tjera administrative	Operacionale	9,060
Subtotali		12,364
Totali:		113,020

Angazhimi i komunitetit serb në punë avokuese dhe procesin e dialogut Kosovë-Serbi

Kjo shtyllë programore u zbatua me fonde të kombinuara, bazë dhe ato të ndara si përkrahje e njëhershme nga OSF, për të adresuar sfidat që sjellë dialogu Kosovë-Serbi. Shumica e aktiviteteve të realizuara ishin operacionale ku fondacioni ishte në krye të dizajnit dhe zbatimit të aktiviteteve.

Që nga fillimi i dialogut Kosovë-Serbi fondacioni është angazhuar që t'i jep mundësi serbëve të Kosovës që zëri i tyre të dëgjohet dhe që ky zë të merret seriozisht nga publiku i gjerë dhe nga elitat politike dhe të amplifikohet që të arrijë edhe deri te faktorët ndërkombëtarë.

Zbatimi i kësaj shtylle programore u mbështet në tri lloje të aktiviteteve (1) punë kërkimore për çka u angazhua DPS i Berlinit, (2) Punëtori dhe tryeza diskutimi, dhe (3) biseda të hapura me analistë dhe ekspert.

Bashkëpunimi i vendosur më herët me në mes të fondacionit dhe Këshillin për demokratizim të politikave (DPS) këtë vit u zgjerua shumë më shumë me punë kërkimore në vendet e banuara me serbë duke trajtuar problematikën e serbëve autokton të Kosovës karshi sfidave të dialogut Kosovë-Serbi dhe procesit të normalizimit të marrëdhënieve në mes të këtyre dy vendeve. Gjatë vitit u finalizua një dokument politikash dhe u kontraktuan edhe tri të tjera të cilat do të finalizohen në fillim të vitit 2020 dhe që të gjitha do të vendosen në funksion të nevojave programore të konceptit. Studimi i përfunduar titullohet: Mbrojta etnike kolektive si mjet i (dez)integritit: Asociacioni i komunave me shumicë serbe. Tri të tjerat do të merren më shumë me mundësitë e vetëqeverisjeve lokale sipas planit të Ahtisaarit për të siguruar integritet të komuniteteve në nivel lokal dhe kualitetin e zbatimit të një marrëveshje e cila ndikon shumë në siguri e që merret me marrëveshjen mbi gjyqësinë dhe policinë. Titujt pune të tri studimeve që do të kryhen vitin e ardhshëm janë: (1) Qeverisja lokale në praktike: nevojë për azhurim të planit

të Ahtisaarit? – Asociacioni i diskutueshëm i komunave me shumicë serbe në perspektive krahasuese, (2) Të drejtat kolektive në praktikë – Ahtisaari minus, (3) Integrimi i gjyqësorit dhe policisë – një sukses të cilit i mungon substanca.

Intervistat e realizuara në terren për këto dokumente u shfrytëzuan njëkohësisht edhe për biseda të hapura me komunitetin të cilat u organizuan në CEC qendrat. Këtë vit patëm 4 biseda të tilla, tri prej së cilave i mbajti Bodo Weber nga DPS, një ku mysafirë ishin Gjeraqina Tuhina dhe Augustin Palokaj të cilët trajtuan të rejat në BE pas zgjedhjeve të tyre dhe efektet dhe pritjet karshi dialogut Kosovë-Serbi.

Janë realizuara dy punëtori dhe tryeza diskutimi dy ditore të cilat shërbyen edhe për punë kërkimore edhe për të shpalosur opinionin e komunitetit serb karshi zhvillimeve në procesin e normalizimit të marrëdhënieve. Punëtorja e parë u mbajt në qershor ku panelist ishin Bodo Weber, Dushan Janjic, Veton Surroi, Miodrag Milicevic dhe Dejan Radivojevic. Kjo punëtori merrej me rolin e shoqërisë civile në procesin e dialogut dhe normalizimit të marrëdhënieve Kosovë-Serbi dhe titullohej: Si të i civilizojmë negociatat. Për të maksimizuar efektet në fund të diskutimit u gjirua edhe një emision "SporaZoom" me panelistët si emision special.

Punëtorja e dytë u organizua ashtu që të shërbejë për dy qëllime, të vazhdoj diskutimin e nisur në qershor mbi përfshirjen më të madhe të shoqërisë civile në procesin e dialogut dhe të i shërbejë fondacionit për konsultim më partnerët e vet lidhur me hartimin strategjisë për ciklit e ardhshëm strategjik. Panelist në këtë diskutim ishin Milan Antonijevic, drejtor i fondacionit në Serbi, Bodo Weber nga DPS dhe Veton Surroi.

Në fund të vitit u mbajt edhe një diskutim i organizuar nga partneri ynë Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik i cili mbledhi një auditorium të gjerë të gazetarëve, korit diplomatik, përfaqësuesve politik dhe shoqërisë civile. Diskutimi u organizua duke marrë për

bazë hulumtimin paraprakisht të bërë: Sa është komuniteti serb në Kosovës qendrore i përgatitur pasojat/përfitimet eventuale nga marrëveshja gjithëpërfshirëse në me të Kosovës dhe Serbisë. Panelistë në këtë diskutim ishin Ardian Arifi, këshilltarë i kryetarit të vendit, Lulzim Peci themelues dhe udhëheqës i KIPRED, ZhivojinRakocevic, shkrimtarë dhe gazetarë dhe BranimirStojanovic, ish nënkryetarë i qeverisë së Kosovës.

Një hulumtim tjetër i cili gjithashtu merret me procesin e dialogut dhe përfshirjen e komunitetit serb të Kosovës që u kontraktua vitin e kaluar me FDMC do të përfundoj gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 dhe menjëherë pas do të bëhet prezantimi i tij në publik si diskutim dhe forma tjera të promovimit me qëllim avokues.

Lista e granteve dhe shpenzimeve tjera:

Emri i Projektit/iniciativës	Grant marrësi	Shuma në Euro
Fuqizimi i pozitës së Kosovës karshi procesit të dialogut dhe normalizimit të marrëdhënieve Kosovë-Serbi – Perpektiva serbe	Operacionale/DPC	20,334.84
Punëtori dhe diskutim: Roli i shoqërisë civile në procesin e dialogut dhe normalizimit të marrëdhënieve Kosovë-Serbi, Durrës 16-18.06.2019	Operacionale	10,406.82
Punëtori dhe diskutim: Roli i shoqërisë civile në procesin e dialogut dhe normalizimit të marrëdhënieve Kosovë-Serbi dhe konsultim lidhur me strategji 2021-2024, Tiranë 15-17.11.2019	Operacionale	9,847.65
Graçanica Bridge Rewiring	Forum për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik (FDMC)	22,810
Subtotali:		66,159.84
Shpenzime programore dhe administrative		
Konsulencë	Operacionale	2,760.53
Shpenzime të printimit	Operacionale	1,900
Shpenzime të përkthimit	Operacionale	1,200
Shpenzime tjera administrative	Operacionale	8,174.25
Subtotali		14,034.78
Totali:		80,194.62
Totali i përgjithshëm:		377,938.22



OSF FONDI REZERVĚ



OSF FONDI REZERVË

Fuqizimi i perspektivës së Kosovës në dialog me Serbinë

Duke e parë si çështje të rëndësishme të madhe, në vitin 2018 Fondacioni inicioi një projekt për të adresuar mungesën e konsensusit rreth dialogut Kosovë-Serbi. Në bashkëpunim me Democratization Policy Council (DPC) nga Berlina dhe duke i përfshirë organizatat e shoqërisë civile në Kosovë, Fondacioni nisi një projekt gjithpërfshirës të partive politike në Kosovë për t'i përafuar qëndrimet e tyre dhe për të fuqizuar perspektivën e Kosovës në finalizimin e një marrëveshjeje gjithpërfshirëse dhe ligjërimit obligativ me Serbinë.

Projekti i cili u përkrah nga Fondi Rezervë i OpenSocietyFoundations gjatë vitit 2018 dhe 2019, u pa si shumë aktual dhe relevant, dhe për këtë arsye Fondacioni ishte përfitues i një rritje unike një vjeçare të buxhetit bazë.

Përderisa gjatë vitit 2018 mundësia se një marrëveshje gjithpërfshirëse do të arrihej brenda mandatit të Komisioneres së Lartë Federica Mogherini (deri në mars të vitit 2019) duke qenë reale, vendimi i Kryeministrit Haradinaj për të vendosur një taksë 100 për qind mbi produktet serbe në dhjetor 2018, çoi në suspendimin e plotë të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë.

Ndonëse dialogu zyrtar u pezullua dhe çfarëdo linjë komunikimi mes dy vendeve u ndërpre, dialogu si ide dhe mjet për arritjen e një paqeje të qëndrueshme me Serbinë ishte temë e zjarritë përgjatë gjithë vitit, jo vetëm në Kosovë por edhe në skenën ndërkombëtare. Zgjedhjet parlamentare evropiane çuan në një Komision të ri, i cili emëroi Josep Borrell, ish-ministrin e punëve të jashtme të Spanjës – një nga shtetet mosnjohëse të pavarësisë së Kosovës – si Përfaqësues të Lartë për Politikë të Jashtme. Borrelli ka paralajmëruar që udhëtimi i tij i parë zyrtar do të jetë në Prishtinë

dhe ka shprehur interesim të jetë aktivisht i involvuar në procesin.

Për të adresuar përkeqësimin e marrëdhënieve në mes Kosovës dhe Serbisë, në prill 2019, Kancelarja gjermane Merkel dhe Presidenti francez Macron i ftuan përfaqësuesit e Ballkanit Perëndimor në Berlin, duke paralajmëruar një proces të ri të ndërmjetësimit që do të vazhdohej me një takim në Paris. Megjithatë, dorëheqja e Haradinaj në qershor dhe mungesa e një qeverie funksionale në Kosovë shtyu takimin për një datë të pacaktuar dhe shënoi simbolikisht fundin e këtij procesi ende të pafilluar.

Një tjetër shenjë që dialogu vazhdonte të konsiderohej kyç në zgjidhjen e problemeve mes Kosovës dhe Serbisë ishte edhe trysnia e ushtruar nga Uashingtoni zyrtar, i cili emëroi jo një, por dy delegatë për tu marrë me dialogun - Matthew Palmer si të dërguar special për Ballkanin Perëndimor, dhe Ambasadorin amerikan në Gjermani, Richard Grenell, si të dërguar special për dialog. Përgjatë 2019, temë e zjarritë diskutimi ishte nëse edhe BE-ja do të duhej të caktonte një përfaqësues special, nga një shtet më miqësor ose së paku indiferent, ndaj pavarësisë së Kosovës.

Ky sfond politik e ndryshoi natyrën e iniciativës së Fondacionit por në një aspekt pozitiv e bëri atë edhe më relevant, sidomos për shkak se iniciativa kishte shërbyer si urë lidhëse në mes të përfaqësuesve politik dhe të shoqërisë civile në Kosovë me kryeqytetet e aleatëve kryesorë të Kosovës.

Përveç takimeve të mbyllura në mes të përfaqësuesve të të gjitha partive politike dhe shoqërisë civile të cilat janë mbajtur gjatë vitit 2018 dhe në fillim të vitit 2019, Fondacioni ka vazhduar të organizojë takime avokuese me përfaqësues politik dhe të shoqërisë civile në qendra ndërkombëtare si Brukseli, Berlina, NewYork-u, Beogradi, Athina dhe Madridi.

Në fund të janarit, Fondacioni organizoi një tryezë të rrumbullakët me përfaqësues të partive dhe shoqërisë civile në Tiranë, Shqipëri. Komentet e bëra gjatë këtij takimi, dhe gjatë atyre të vitit paraparak, u shfrytëzuan për të përpiluar një “non-paper”, dokument që përmbledhë pikat konsensuale mes të gjitha partive në Kosovë. Në dy muajt në vijim Fondacioni mbështeti partnerët e saj që me këtë nonpaper të informonin akterët kyç në SHBA, Gjermani dhe BE në lidhje me pozitën e mundshme dhe rrugën që Kosova duhej të ndiqte kur palët të ktheheshin në tavolinën e dialogut.

Në janar dhe shkurt, partnerë dhe përfaqësues të Fondacionit organizuan takime avokuese në Bruksel dhe Berlin, për të ngritur vetëdijen në këto dy qendra kyçe në lidhje me gjendjen në skenën politike në Kosovë, nevojën për një kyçje konstruktive të BE-së dhe Gjermanisë në dialog.

Përveç takimeve të mbyllura, Fondacioni vazhdoi të inicojë, organizojë dhe mbështesë një seri diskutimesh publike për të nxitur debat në lidhje me nevojën për dialog, por edhe për të problematizuar mënyrën se si dialogu ishte udhëhequr deri në vitin 2018. Në mars, në bashkëpunim me Forumin për Marrëdhënie Etnike (FER), u organizua një tryezë diskutimi “Dialogu diplomatik: një paradigmë e re për Kosovën dhe Sërbinë”, në Beograd ku edhe u prezantua “paradigmi i ri” për dialogun. Prezantimi në Beograd ringjalli debatin për nevojën e dialogut dhe domosdoshmërinë e nisjes së një procesi të ri, politik dhe të ridefinuar.

Në qershor, Fondacioni organizoi Bisedën e Hapur, të titulluar “Pas Berlinit, Para Parisit” - një diskutim joformal i mbrëmjes në mes të Veton Surroit, publicist dhe shkrimtar, Blerim Shalës, këshilltar i Presidentit të Kosovës, dhe Dr. Mark Baskin, profesor i marrëdhënieve ndërkombëtare në RIT, në Prishtinë.

Përderisa zgjedhjet e tetorit e pauzuan iniciativën përkohësisht, në vjeshtë Fondacioni inicoi edhe një seri takimesh dhe tryezash duke i synuar politikbërësit në qytete që do të luajnë rol

vendimmarrës në hapat e ardhshëm të procesit.

Në fund të nëntorit, në bashkëpunim me European Policy Center (EPC) në Bruksel, Fondacioni organizoi panelin e hapur “Stuck in limbo? The future of the Belgrade-Prishtina dialogue” në Bruksel. Një numër i madh i përfaqësuesve të institucioneve evropiane, diplomatëve dhe ekspertëve të tjerë që merren me Ballkanin Perëndimor ishin prezentë dhe kontribuan në diskutim.

Në fund të vitit, Fondacioni ktheu fokusin edhe kah vendet mosnjohëse që kanë luajtur rol kyç përkrahës të proceseve bashkëpunuese rajonale, siç është Greqia, ose kanë qenë kundërshtarë seriozë të pavarësisë së Kosovës, siç është Spanja.

Me 28 nëntor, në bashkëpunim me Fondacionin Helenik për Çështje Evropiane dhe të Jashtme, ELIAMEP, Fondacioni organizoi një ngjarje tërëditore në Athinë, Greqi. Ndonëse e mbyllur për media, diskutimi i titulluar “Addressing challenges to the European integration of the Western Balkans: The Belgrade-Prishtina dialogue after the elections in Kosovo” mblodhi një nivel të lartë të diplomatëve dhe përfaqësuesve politik në Athinë.

Me 13 dhjetor në bashkëpunim me Institutin Mbretëror Elcano dhe European Center for Foreign Relations, ECFR, në Madrid, Fondacioni organizoi një ngjarje tërëditore të mbyllur të titulluar “The new European Commission and the Western Balkans: The past, present and future of Kosovo-Serbia relations” në Madrid, Spanjë. Gjatë kësaj dite, përfaqësues të shoqërisë civile në Kosovë patën mundësinë për të diskutuar me akterë kyç në Madrid, duke përfshirë edhe shoqërinë civile atje, në lidhje me perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor pas dokumentit francez (të botuar në nëntor).

Tabela e granteve dhe shpenzimeve tjera: Buxheti Bazë

Titulli i projektit	Grantist	Shuma në euro
Dialogu diplomatik: Një paradigmë e re për Kosovën dhe Sërbinë	Forumi për Marrëdhënie Etnike, FER	3,580.00
Autostrada Biennale II “Revolucioni jemi ne”	Autostrada Biennale	12,000.00
“Sfidat e reja në rrugën e integriteteve evropiane”	Instituti Riinvest	9,320.00
Tryeza e rrumbullaktë me EPC në Bruksel “ Stuck in Limbo? The Future of Pristina-Belgradedialogue” me 20.11.19	Operacional	5,245.36
Organizimi i tryezës me ELIAMEP në Athinë “Adresimi i sfidave të Ballkanit Perëndimor” me 28.11.19	Operacional	2,817.23
Mbështetje për promovim të librit “Politics of Recognition” në London School of Economics me 4.12.19	Operacional	1,453.33
Organizim i tryezës me Elcano dhe ECFR në Madrid, 11-15.12.19	Operacional	3,932.70
Shërbime konsulence ndërlidhur me zyrën e Nju Jorkut	Operacional	13,912.77
Shërbime konsulence ndërlidhur me zyrën e Nju Jorkut	Operacional	13,952.42
Shërbime konsulence për iniciativën “Fuqizimi i perspektivës së Kosovës”	Operacional	20,800.00
	Subtotali	87,013.81
Shpenzime programore		
Publikim dhe printim		4,268.66
Shërbime përkthimi		1,026.57
Shpenzime tjera administrative programore		3,653.81
	Subtotali	8,949.04
	Totali	95,962.85

Tabela e granteve dhe shpenzime tjera: Fondi Rezervë nga OSF

Titulli i projektit	Grantist	Shuma në euro
Takime avokues ne Bruksel 20-21.01.19	Operacional	4,969.37
Takim planifikues me partnerë në Berlin 21-.23.01.19	Operacional	5,458.71
Tryezë e mbyllur me përfaqësues politikë dhe shoqëri civile në Tiranë 25-27.01.2019	Operacional	11,832.02
Takime avokuese me përfaqësues politik në Berlin 17-19.02.2019	Operacional	5,511.79
Udhëtim avokues në Washington DC, NewYork 25.02.-03.03.19	Operacional	13,895.60
Pjesëmarrje në tryezën e organizuar në bashkëpunim me FER në Beograd 13.-15.03.19	Operacional	4,811.07
Takim me përfaqësues të OSF në Tiranë 28-29.09.19	Operacional	1,929.95
Akomodim për konsulentë të zyrës OSF	Operacional	€220.13
Publikimi i parimeve udhëheqëse për negociata	Operacional	4,900.00
Prezentime në Bruksel, Berlin dhe SHBA	Operacional	4,200.00
Shërbime konsulence	Operacional	29,185.50
Shërbime të përkthimit	Operacional	4,699.50
Shpenzime tjera administrative programore	Operacional	4,951.36
Total		96,565.00

Marrëdhëniet Kosovë – Shqipëri: Hulimtim mbi qëndrimet në të dy anët e kufirit

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) dhe Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) në fund të vitit 2018 kanë përfunduar një hulumtim të gjerë në Kosovë dhe Shqipëri për të matur ndërveprimin dhe qëndrimet e qytetarëve të të dyja vendeve sa i përket një sërë çështjesh, si: ndërveprimi, distanca sociale, imazhet për fqinjët, qëndrimet ndaj bashkëpunimit zyrtar të të dyja vendeve dhe qëndrimet ndaj bashkimit kombëtar. Gjatë tetorit dhe nëntorit 2018 janë anketuar 2,504 qytetarë në të dyja vendet: 1,200 në Shqipëri dhe 1,304 në Kosovë (1,004 shqiptarë dhe 300 serbë). Mbledhja e të dhënave është realizuar sipas të njëjtës metodologji, por nga dy kompani të ndryshme, përkatësisht IDRA në Shqipëri, ndërsa Kantar TNS Index Kosova në Kosovë. Format i anketës dhe numri i pyetjeve ka qenë i njëjtë në të dyja vendet, kurse për qytetarët serb në Kosovë është përdorur një version më i shkurtër i anketës.

Gjatë vitit 2019 janë mbajtur pesë takime në mes fondacioneve dhe partnerëve nga Kosova dhe Shqipëria. Raporti *Kosovë – Shqipëri Ndërveprimi, njohuritë, vlerat, besimet, bashkëpunimi dhe bashkimi* tashmë është publikuar. Agron Demi dhe Blendi Çeka janë autorë të raportit. Ky projekt është mbështetur nga fondi rezervë i Open Society Foundations - OSF.

Ky hulumtim nuk ka qenë qëllimi përfundimtar i kësaj nisme të përbashkët të OSFA dhe KFOS, por është hapi i parë në serinë e disa aktiviteteve të cilat synojnë të analizojnë dhe nxisin debatin për thellimin e bashkëpunimit mes Kosovës dhe Shqipërisë, si projekt i rëndësishëm në zgjerimin dhe thellimin e bashkëpunimit rajonal. Pas takimeve në mes të dy fondacioneve dhe partnerëve të tyre është vendosur që të vazhdohet me këtë bashkëpunim në mes të organizatave të shoqërisë civile në Kosovë dhe Shqipëri për t'i hulumtuar më thellë katër

tema: 1. Bashkëpunimitregtar i Kosovës me Shqipërinë: Sfidat dhe potencialet 2. Përmirësimi i bashkëpunimit Shqipëri – Kosovë në sektorin e arsimit 3. Shqipëria dhe Kosova: Cila është e ardhmja? – Dekonstruktimi i idesë së bashkimit dhe 4. Bashkëpunimi energjetik Kosovë – Shqipëri: Mundësitë dhe sfidat.

Tri temat e para i kanë përfunduar studimet dhe do të vazhdojnë me aktivitetet e avokimit. Varësisht nga situata politike pas zgjedhjeve të 6 tetorit 2019 në Kosovë, do të caktohet koha e publikimit dhe aktiviteteve tjera të planifikuara. Ndërsa, tema e katërt është në fillim të realizimit të projektit.

Përveç avokimit të secilës organizatë veçmas, është planifikuar që në shkurt 2020 të organizohet një tryezë e Forum 2015, në të cilën do të prezantohen analizat dhe diskutohen këto tema.

Bashkëpunimi tregtar i Kosovës me Shqipërinë: Sfidat dhe potencialet

Ky projekt ka për qëllim vetëdijësimin e akterëve politik dhe poashtu sektorit privat lidhur me përfitimet e shfrytëzimit të potencialit ekonomik përmes rritjes së shkëmbimeve tregtare Kosovë – Shqipëri. Për më tepër, ky projekt synon nxitjen e një debati gjithëpërfshirës të bazuar në fakte përtej retorikës politike.

Deri më tani kanë përfunduar të gjitha aktivitetet dhe është draftuar versioni i parë i raportit të studimit. Publikimi dhe aktivitetet tjera avokuese do të realizohen gjatë vitit 2020.

Përmirësimi i bashkëpunimit Shqipëri – Kosovë në sektorin e arsimit

Objektivat e këtij projekti që për qëllim ka përmirësimin e bashkëpunimit Kosovë-Shqipëri në sektorin e arsimit, janë: 1. Të sigurohen marrëveshjet ekzistuese për bashkëpunim 2. Të identifikohet

hen çështjet/procese me potencial të cilat prodhojnë derivate të reja bashkëpunimi/përafrimi 3. Të hartohet raporti paraprak për këtë bashkëpunim 4. Të hartohet Udhërrëfyesi me rekomandime specifike afatshkurtëra dhe afatmesme dhe 5. Aktivitetet e avokimit.

Të gjitha këto objektiva janë arritur, ka mbetur vetëm pjesa e avokimit. Në kuadër të këtij aktiviteti është paraparë prezantimi publik i Udhërrëfyesit, i shoqëruar me debat rreth bashkëpunimit, disa artikuj në media, si dhe pjesëmarrjen në TV emisione të cilat do ta kishin temë bashkëpunimin Shqipëri-Kosovë. Ngecja në formimin e Qeverisë ka bërë që kjo pjesë e projektit të shtyhet për pak kohë.

Shqipëria dhe Kosova: Cila është e ardhmja? – Dekonstruktimi i idesë së bashkimit

Projekti synon që të jap kontribut në trasimin e debatit politik në Kosovë dhe Shqipëri për përmirësimin dhe thellimin e marrëdhënieve strategjike dypalëshe, duke përfshirë edhe zbërthimin e idesë së bashkimit të tyre. Objektivat e projektit janë: 1. Intensifikimi i bashkëpunimit në mes të organizatave të shoqërisë civile të Kosovës dhe Shqipërisë në trajtimin e temave të interesit publik 2. Vlerësim kritik i marrëdhënieve të tanishme dhe të ardhme politike në mes të dy vendeve 3. Shqyrtim i mundësive dhe kufizimeve për idenë e bashkimit që rrjedhin nga rendet kushtetuese vendore, e drejta ndërkombëtare, integrimet dhe anëtarësimi në strukturat Euro-Atlantike dhe 4. Ngritja e nivelit të debatit për opcionet realiste të zhvillimit të marrëdhënieve strategjike në mes të dy vendeve. Deri më tash është përfunduar ridraftimi i punimit dhe së shpejti do të vazhdohet me aktivitetet avokuese.

Bashkëpunimi energjetik Kosovë – Shqipëri: Mundësitë dhe sfidat

Ky projekt ka për qëllim të trajtojë sfidat dhe mundësitë reale të bashkëpunimit energjetik ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Duke qenë se një studim i detajuar në këtë fushë mungon, i njëjti mund të shërbejë si informues i mirë i politikave publike që mund të ndiqen nga qeveritë e dy vendeve. Projekti ka filluar realizimin në fund të vitit 2019, ndërsa në muajin maj 2020 do të publikohet raporti dhe do të fillojnë aktivitetet e avokimit.

Tabela e granteve dhe shpenzimeve tjera

Emri i Projektit	Grantist	Shuma në Euro
Shqipëria dhe Kosova: Cila është e ardhmja? – Dekonstruktimi i idesë së bashkimit	KIPRED	15,000
Përmirësimi i bashkëpunimit Shqipëri – Kosovë në sektorin e arsimit	Qendra Kosovare për Arsim	25,000
Bashkëpunimi tregtar i Kosovës me Shqipërinë: Sfidat dhe potencialet	Instituti Riinvest	14,965
Bashkëpunimi tregtar i Kosovës me Shqipërinë: Sfidat dhe potencialet	Instituti GAP	14,580
The Bridge	The Bridge	3,000
Bashkëpunimi energjetik Kosovë – Shqipëri: Mundësitë dhe sfidat	Instituti Riinvest	18,000
	Subtotal	90,545
Takime me OSFA dhe Partnerët		
Takimi në mars		3,710.14
Takimi në prill		2,129.68
Takimi në shtator		4,980.27
Takimi në nëntor		2,833.86
Takimi në nëntor		1,718.01
	Subtotal	15,371.96
Konsulenca		6,722.47
	Subtotal	6,722.47
Shpenzime tjera programore		
Publikime dhe shtyp		6,415.40
Shpenzime administrative		613
	Subtotal	7,028.40
	Grand Total	119,667.83



PROJEKTET ME FONDE TË PALËVE TË TRETA



PROJEKTET ME FONDE TË PALËVE TË TRETA

Projektet e zbatuara nga fondet e palëve të treta në përkrahje të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Gjatë vitit 2019 përfunduan dy projekte të përkrahura nga fondet e donatorëve tjerë: 1. Projekti Prospect Plus i përkrahur nga Ministria e Zhvillimit e Republikës së Gjermanisë i cili financohej përmes Karl Kubel Stiftung me buxhet total prej 527.000 € dhe projekti EU SIMRAES II i përkrahur me 1.3 milion € nga Bashkimi Evropian përmes IPA fondeve.

Karl Kubel Stiftung vazhdoi bashkëpunimin me fondacionin në zbatim të projektit Prospect 3 për katër vite të ardhëshme, deri në 2023, me buxhet prej 575,000 € për të adresuar nevojat e të rikthyerve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në katër lokacione, dy në komunën e Suharekës dhe dy në komunën e Pejës.

Në vazhdim janë të përshkruara të arriturat kryesore të dy projekteve.

Promovimi i integritit të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Pejës dhe të Suharekës, Kosovë – Prospect Plus

Projekti *Prospect Plus* është zbatuar në dy komuna (Pejë dhe Suharekë), duke filluar nga nëntori i v.2015, dhe përfunduar më 30 prill 2019. Projekti ka kontribuar në realizimin e strategjisë shtetërore për integrimin e komunitetit rom dhe ashkali duke e përmirësuar qasjen në shërbimet për arsim, shëndetësi dhe çështje sociale. Andaj synimi i përgjithshëm i Projektit Prospect Plus ka qenë të kontribuojë në realizimin e të drejtave të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në Kosovë, respektivisht në komunën e Pejës dhe të Suharekës, dhe në integrimin e tyre në shoqërinë kosovare. Për të kontribuar në arritjen e këtij qëllimi të përgjithshëm, Projekti Prospect Plus ka

marrë mbi vete obligimin të arrijë një qëllim të caktuar, i cili është që në katër lagje në dy komunat e cekura ku jeton komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian të përmirësohet qasja në shërbimet për arsim, shëndetësi dhe çështje sociale si një hap i rëndësishëm drejt rritjes së pjesëmarrjes ekonomike dhe sociale si dhe të integritit social.

Projekti ka ndërmarrë një varg masash dhe aktivitete në fushat e arsimit dhe të shëndetësisë, të cilat janë të përfshira në Strategjinë dhe Planin e veprimit për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë. Ato janë realizuar, monitoruar dhe zhvilluar së bashku me grupet e synuara, OJQ-të partnere si dhe palët relevante për të siguruar qëndrueshmërinë edhe pas përfundimit të projektit.

Janë gjithsej tri fusha të intervenimit me këtë projekt, të shprehura si qëllime të projektit:

Fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë në katër lokacione janë të integruar në shkollën fillore (nivelelën parashkollor, fillor dhe të mesëm të ulët)

Të gjitha aktivitetet e projektit janë zhvilluar në 2 Qendrat Mësimore në komunën e Pejës, gjegjësisht në Vitomiricë dhe në lagjen 7 Shtatori në Pejë, dhe në 2 Qendrat Mësimore në komunën e Suharekës, në fshatrat Leshan dhe në Gelancë. Në secilën QM tutorët u kanë ndihmuar fëmijëve që kanë vështirësi në nxënie, vijueshmëri të parregullt ose janë rikthyer nga emigrimi. Përveç kësaj tutorët kanë ndërmjetësuar me mësuesit, autoritetet shkollore dhe prindërit ashtu që të forcohet bashkëpunimi i prindërve me shkollën me qëllim që të rritet edhe përfshirja e prindërve në ndihmë fëmijëve të tyre. Si rezultat është rritur vijueshmëria ose zvogëluar numri i mungesave të nxënësve dhe është rritur suksesi apo nota mesatare e nxënësve që vijnë nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. QM kanë ndërmarrë gjithashtu edhe

aktivitete ndërkulturore, të karakterit rekreativ dhe mësimor, në të cilat janë përfshirë fëmijët e komunitetit rom, ashkali, egjiptian, shqiptar dhe boshnjak. Aktivitetet ndërkulturore kanë çuar drejt uljes së shkallës së diskriminimit, të stereotipeve dhe paragjyqimeve që fëmijët kanë ndaj njëritjetrit. Projekti ka ndërmarrë gjithashtu aktivitete ndërgjegjësuese: janë ndërmarrë fushata intensive për ndërgjegjësimin e prindërve/familjarëve për të regjistruar ose mbajtur fëmijët e tyre në shkolla.

Komuniteti i synuar rom, ashkali dhe egjiptian e përmirësojnë qasjen e tyre në shërbimet shëndetësore dhe sociale dhe fitojnë më shumë njohuri dhe informata rreth çështjeve që kanë të bëjnë me shëndetin

Aktivitetet janë realizuar në mëhalla/lagje të lokacioneve të projektit, shpesh duke u ndërmarrë edhe nëpër shtëpitë e familjeve që vijnë nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. Për këtë qëllim janë angazhuar ndërmjetësueset shëndetësore dhe sociale, si personel i projektit por që vijnë nga vet komunitetet e tilla. Përqendrimi ka qenë kryesisht në gratë dhe vajzat, meqë në fillim kanë qenë mjaft hezituese në marrjen e shërbimeve mjekësore por edhe atyre sociale. Në marrëveshje me autoritetet shëndetësore komunale, sidomos me QMF-të (Qendrat e Mjekësisë Familjare) ndërmjetësueset kanë organizuar vizitat mobile të mjekëve dhe specialistëve mjekësorë në lagje, ku mjekët kryenin kontrolle rutinoire dhe specialistike nëpër shtëpi, duke kontrolluar kështu gratë, vajzat, djemtë dhe burrat që kishin probleme shëndetësore. Gjithashtu ndërmjetësueset, në formë të organizuar, kanë sjellë pjesëtarët e komuniteteve nga mëhallat në QMF për të kryer kontrollet ose vizitat specialistike. Aktivitet tjetër me rëndësi që e kanë ndërmarrë ndërmjetësueset është organizimi i takimeve ose seancave këshilluese kryesisht për gratë dhe vajzat e komunitetit: dy herë në muaj, në secilin lokacion të projektit, janë sjellë mjeket ose specialistët, në njërin nga shtëpitë e familjarëve në mëhallë, në të cilën seancë kanë marrë pjesë rreth 15-20 gra dhe vajza. Seancat kanë qenë të tipit këshillues, gjersa temat që janë diskutuar janë ngritur ose përzgjedhur nga vet gratë ose vajzat. Çdo të dytin muaj temat këshilluese kanë qenë të natyrës sociale, në të cilën kanë marrë pjesë edhe burrat dhe djemtë, ku temat kanë qenë të ngritura ose të përzgjedhura

nga vet ata. Disa nga temat e tilla kanë qenë e drejta në përfitimin e skemës sociale, raportet ndërmjet anëtarëve të familjes, punësueshmëria etj. Në monitorimin e kësaj komponente është angazhuar personeli i Asociacionit i Mjekësisë Familjare të Kosovës (AMFK) që ka monitoruar punën e ndërmjetësueseve dhe ka mentoruar ato, gjithashtu duke ndihmuar edhe QMF-të të mobilizohen në ndihmë shëndetësore të familjeve brenda mëhallave/lagjeve të komuniteteve.

Njënumëri OJQ-ve (Rrjeti PROSPECT) angazhohet dhe avokon për implementimin e planeve komunale të veprimit për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian

Rrjeti PROSPECT përbëhet nga organizatat partnere të projektit Prospect +, përfshirë organizatat që kanë qenë të angazhuara në projektin e mëhershëm Prospect (NVK, BCS, SiV, SHL-K dhe Vizioni 02). Si komuna e Pejës ashtu edhe ajo e Suharekës nuk kanë plane të veprimit apo strategji lokale për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Planet e veprimit dhe strategjitë që i kanë pasur kanë skaduar para 10 (Pejë) respektivisht 3 vjetëve (Suharekë) duke i bërë kështu komunat të ndërmarrin më pak masa sa i përket integritit të këtyre komuniteteve. Meqenëse në nivel qendror është aprovuar strategji e tillë me planin e veprimit, deri në vitin 2021, organizatat partnere gjithë kohës kanë avokuar nëpër komuna që të realizohen masat e planifikuara të dokumentit strategjik që buron nga Zyra për Qeverisje të Mirë të kabinetit të Kryeministrit. Përgjatë projektit partnerët lokalë (Nevo Koncepti – Suharekë dhe Syri i Vizionit – Pejë) çdo muaj kanë pasur takime me drejtorët e sektorëve komunalë të shëndetësisë, arsimit dhe të mirëqenies sociale, jo vetëm për të koordinuar aktivitetet e projektit por edhe për zhvillimin e politikave komunale të favorshme edhe për pjesëtarët e komuniteteve. Takimet e këtyra janë përcjellë me praninë e zyrtarëve komunalë të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, të cilët gjithë kohës kanë shtruar nevojën për të pasur një dokument të tillë. Në takimet e fundvitit edhe me kryetarët e komunave, komunat kanë marrë vendim që në vitin 2019 të planifikojnë nisjen e hartimit të strategjisë lokale dhe planit të veprimit për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Në nivel qendror organizatat partnere

si rrjet PROSPECT kanë qenë pjesëmarrës në hartimin e Udhëzimit Administrativ të ri të MASHT (Nr.17/2018) i cili rregullon funksionimin e Qendrave Mësimore dhe përkrahjes financiare të tyre.

Grupi i synuar i Prospect Plus ishte komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në katër lokacione (mëhalla) në dy komuna, të cilët përbëjnë rreth 2100 pjesëtarë. Komuniteti i synuar është: paralagjia “7 Shtatori” dhe fshati Vitomiricë në Komunën e Pejës, si dhe fshati Gelancë dhe Leshan/Tërne në Komunën e Suharekës.

me theks të veçantë në të kthyerit nga vendet e Bashkimit Evropian, sidomos nga Gjermania. Përtë kontribuar në arritjen e këtij qëllimi të përgjithshëm, Projekti Prospect 3 ka marrë mbi vete obligimin të arrijë një qëllim të caktuar, i cili është që në katër lagje në dy komunat e cekura ku jeton komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian të përmirësohet qasja në shërbimet për arsim, shëndetësi dhe çështje sociale, si dhe në punësueshmëri, si një hap i rëndësishëm drejt rritjes së pjesëmarrjes ekonomike dhe sociale si dhe të integritimit social.

Lista e grantevetë shpërndara partnerëve lokalë për vitin 2019 (janar – prill)

Emri i projektit	Grantisti	Shuma
Realizimi i aktiviteteve mësimore, të ndërmjetësimit shëndetësor dhe social, dhe të rrjetëzimit dhe avokimit	Nevo Koncepti	10,580
Realizimi i aktiviteteve mësimore, të ndërmjetësimit shëndetësor dhe social, dhe të rrjetëzimit dhe avokimit	Syri i Vizionit	10,580
Subtotali:		21,160

Re/Integrimi i romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve të cenueshëm dhe të kthyer në komunën e Pejës dhe të Suharekës, Kosovë (Prospect 3)

Projekti *Prospect 3* është vazhdimësi e projektit Prospect Plus, i cili është zbatuar në dy komuna të Kosovës (Pejë dhe Suharekë). Projekti Prospect 3 zbatohet në po këto dy komuna, duke filluar nga maji i v. 2019. Projekti synon të vazhdojë t’i kontribuojë realizimit të strategjisë shtetërore për integrimin e komunitetit rom dhe ashkali duke e përmirësuar qasjen në shërbimet për arsim, shëndetësi dhe çështje sociale. Kësaj i është shtuar edhe komponenta e punësueshmërisë, me çka synohet të kontribuohet në krijimin e parakushteve për punësim të komuniteteve. Andaj synimi i përgjithshëm i Projektit Prospect 3 është të kontribuojë në realizimin e të drejtave të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve në Kosovë, respektivisht në komunën e Pejës dhe të Suharekës, dhe në integrimin e tyre në shoqërinë kosovare,

Projekti parasheh një varg masash dhe aktiviteteve në fushat e arsimit, shëndetësisë dhe të punësimit. Ato realizohen, monitorohen dhe zhvillohen së bashku me grupet e synuara, OJQ-të partnere si dhe palët relevante për të siguruar qëndrueshmërinë edhe pas përfundimit të projektit.

Grupi i synuar

Grupi i synuar i Prospect 3 janë komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në katër lokacione (mëhalla) në dy komuna, të cilët përbëjnë rreth 2200 banorë. Komuniteti i synuar është: paralagjia “7 Shtatori” dhe fshati Vitomiricë në Komunën e Pejës, si dhe fshati Gelancë dhe Leshan/Tërne në Komunën e Suharekës. Në secilin prej katër lokacioneve ka nga një shkollë fillore e cila ofron arsim parashkollor për fëmijët e moshës pesëvjeçare, arsim fillor për fëmijët nga 6 deri 10 vjeç, si dhe arsim të mesëm të ulët për fëmijët nga 11 deri 14 vjeç.

Objektivat dhe realizimi i tyre

Janë gjithsej tri fusha të intervenimit me këtë projekt, të shprehura si qëllime të projektit:

Fëmijët romë, ashkali dhe egjiptas në katër-lokacionet synuara vijnë rregullisht shkollimin dhe është siguruar vijueshmëria e tyre (nivelin parashkollor, fillor dhe të mesëm të ulët).

Aktivitetet e projektit kanë nisur dhe vazhdojnë të realizohen në dy 2 Qendrat Mësimore në komunën e Pejës, gjegjësisht në Vitomicë dhe në lagjen 7 Shtatori në Pejë, dhe në 2 Qendrat Mësimore në komunën e Suharekës, në fshatrat Leshan dhe në Gelancë. Në këto qendra janë të angazhuar tutorët, të rinj të përkushtuar të komunitetit, që i ndihmojnë fëmijët që kanë vështirësi në nxënie, vijueshmëri të parregullt ose janë rikthyer nga emigrimi. Gjithashtu tutorët ndërmjetësojnë me mësuesit, autoritetet shkollore dhe familjet e nxënësve ashtu që të forcohet bashkëpunimi me shkollën. Si rezultat është rritur vijueshmëria ose zvogëluar numri i mungesave të nxënësve dhe është rritur suksesi apo nota mesatare e nxënësve që vijnë nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. Qendrat Mësimore gjithë kohës kanë ndërmarrë edhe aktivitete ndërkulturore të karakterit rekreativ dhe mësimor, në të cilat janë përfshirë fëmijët e komunitetit rom, ashkali, egjiptian, shqiptar dhe boshnjak. Aktivitetet ndërkulturore kanë çuar drejt uljes së shkallës së diskriminimit, të stereotipeve dhe paragjyqimeve që fëmijët kanë ndaj njëritjetrit. Projekti ka ndërmarrë gjithashtu aktivitete ndërgjegjësuëse: janë ndërmarrë fushata intensive për ndërgjegjësimin e prindërve/familjarëve për të regjistruar ose mbajtur fëmijët e tyre në shkolla. Për të zhvilluar papengueshëm aktivitetet e projektit në lagjet e përmendura, me fillimin e vitit të ri shkollor 2019 KFOS gjithashtu, përmes partnerëve lokalë, ka bërë shpërndarjen e mjeteve didaktike mësimore për të paktën 200 fëmijë të komuniteteve që vijnë në mësimin në lagjet ku gravitojnë shkollat e përfshira në projekt.

Pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian përmirësojnë situatën e tyre shëndetësore dhe cilësinë e jetës.

Aktivitetet ndërmerren nga personeli i përgatitur si ndërmjetëse shëndetësore dhe sociale, që

përbëhen nga vajzat e komunitetit. Këto gjithë kohës kanë realizuar aktivitete shëndetësore në mëhalla/lagje të lokacioneve të projektit, shpesh duke i ndërmarrë ato aktivitete edhe nëpër shtëpitë e familjeve që vijnë nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. Përqendrimi ka qenë kryesisht në përfitueset gra dhe vajza, meqë në familjet e komuniteteve janë më të sfiduarat. Në marrëveshje me autoritetet shëndetësore komunale, sidomos me QMF-të (Qendrat e Mjekësisë Familjare) ndërmjetësueset kanë organizuar vizita mobile të mjekëve dhe specialistëve mjekësorë në lagje, ku mjekët kryenin kontrole rutinore dhe specialistike nëpër shtëpi, duke kontrolluar kështu gratë, vajzat, djemtë dhe burrat që kishin probleme shëndetësore. Përveç kontrollove mjekët kanë mbajtur dhe ligjërata për çështje të ndryshme shëndetësore, sidomos për çështjet që më së shumti i preokuponin pjesëtarët e komuniteteve. Aktivitet tjetër me rëndësi që e kanë ndërmarrë ndërmjetësueset është organizimi i takimeve ose seancave këshilluese kryesisht për gratë dhe vajzat e komunitetit: dy herë në muaj, në secilin lokacion të projektit, janë sjellë mjekët ose specialistët, në njërin nga shtëpitë e familjarëve në mëhallë, në të cilën seancë kanë marrë pjesë rreth 15-20 gra dhe vajza. Çdo të dytin muaj temat këshilluese kanë qenë të natyrës sociale, në të cilën kanë marrë pjesë edhe burrat dhe djemtë, ku temat kanë qenë të ngritura ose të përzgjedhura nga vet ata, si psh e drejta në përfitimin e skemës sociale, raportet ndërmjet anëtarëve të familjes, punësueshmëria etj. Në mentorimin e kësaj komponente është angazhuar personeli i Asociacionit i Mjekësisë Familjare të Kosovës (AMFK) që ka monitoruar punën e ndërmjetësueseve dhe i ka mentoruar ato, gjithashtu duke ndihmuar edhe QMF-të të mobilizohen në ndihmë shëndetësore të familjeve brenda mëhallave/lagjeve të komuniteteve. Projekti në fund të vitit 2019 ka organizuar edhe trajnimet me modulën e “Shkathtësitë Prindërore”, ku grupet e grave të komunitetit nga lokacionet e projektit në Pejë dhe Suharekë kanë ndjekur modulën tre-ditor për rritjen e shkathtësive të prindërimit.

Komuniteti i synuar rom, ashkali dhe egjiptian, mestyre edhe familjet e kthyera, përmirësojnë perspektivën e punësueshmërisë

Lidhur me punësueshmërinë, në mesin e banorëve në lokalitetet e synuara janë identifikuar të papunët të cilën nuk janë regjistruar në zyrat e punësimit. Gjatë identifikimit banorëve u janë evidentuar shkathtësitë që i kanë dhe të dhënat tjera që ndërlidhen me punësimin e tyre. Të paktën 40 të papunët të interesuar kanë kaluar në trajnimin në modulën “Aplikimi i suksesshëm”, i cili është mbajtur nga Agjencioni i Përkrahjes së Punësimit në Kosovë (APPK). Modulet e trajnimit kanë të bëjnë me rritjen e shkathtësive të buta, të cilat janë parakusht për kyçje në tregun e punës. Në vitin 2019 është zgjeruar bashkëpunimi me Qendrat Rajonale të Punësimit, Qendrat e Aftësisimit Profesional dhe Zyrat e Punësimit në komuna. Bashkëpunimi ka nisur me ndarjen e informacionit, meqenëse këto autoritete të punësimit fillimisht nuk e kanë pasur të gjithë informacionin mbi punësueshmërinë e banorëve të komuniteteve në lokacionet e projektit. Bashkëpunimi është duke vazhduar me ndarjen e informacionit nëpër lagje / shtëpi lidhur me mundësitë që ofrohen nga autoritetet për përgatitjen e banorëve të lagjeve për kyçje në tregun e punës. Projekti gjithashtu është duke ndërmjetësuar në kyçjen e pjesëtarëve të komuniteteve në tregun e punës, së pari duke identifikuar vendet vakante në sektorin privat, pastaj duke ofruar informacionin tek banorët e interesuar dhe në fund duke i referuar sektorit privat banorët e interesuar për punë të cilët kanë set të caktuar të shkathtësive.

Organizatave që punojnë në arsimimin, shëndetësinë, mirëqenien sociale dhe punësueshmërinë e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve, përmirësojnë kapacitetet e tyre për të ofruar shërbime cilësore për përfituesit e tyre, dhe avokojnë me autoritetet lokale dhe qendrore për një pozitë më të mirë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

Rrjeti PROSPECT përbëhet nga organizatat partnere të projektit Prospect +, përfshirë organizatat që kanë qenë të angazhuara në projektin e mëhershëm Prospect (Nevo Koncepti, Bethany

Christian Services, Syri i Vizionit, SHL-Kosova dhe Vizioni 02). Me realizimin e projektit Prospect të gjitha këto organizata i kanë ndërtuar ose përmirësuar kapacitetet për punë me komunitete në çështjet më të ndieshme për ta, si psh arsimi, shëndetësia, punësueshmëria. Gjithashtu këto organizata i kanë forcuar kapacitetet organizative dhe menaxhuese meqenëse projektet Prospect janë projekte komplekse, me komponente të ndërlidhura që kërkojnë jo vetëm menaxhim por edhe administrim të kujdeshëm. Në çështjet e avokimit, rrjeti i Prospect-it ka përgatitur këto organizata për avokim të fuqishëm: secila prej këtyre organizatave ka ngritur çështje të ndryshme në komunat e veta, të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e cilësisë së jetës për komunitetet. Thuaja të gjitha çështjet e ngritura janë trajtuar nga autoritetet, gjersa vet komunitetet kanë vazhduar të avokojnë për çështjet tjera që i kanë si shqetësim. Këto organizata janë duke vazhduar të avokojnë që komunat të kenë plane të veprimit të përditësuar për integrimin e komuniteteve, gjersa të gjitha së bashku, në cilësinë e rrjetit, janë duke vazhduar të ushtrojnë presion tek autoritetet qendrore për realizimin e strategjisë nacionale për integrimin e komuniteteve. Rrjeti në vitin 2019 është përfshirë në hartimin dhe realizimin e Udhëzimit Administrativ të MASHT për Qendrat Mësimore, dhe duke qenë pjesë edhe ekipeve monitoruese për zbatimin e strategjisë nacionale për integrim të komuniteteve, kanë kontribuar në procesin e monitorimit dhe të vlerësimit të zbatimit të politikave shtetërore për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë.

Shuma e granteve e shpërndarë në partnerë lokalë për vitin 2019

Grant marrësi	Titulli i projektit/iniciativës	Shuma në Euro
Nevo Koncepti (NVK)	Realizimi i aktiviteteve mësimore, të ndërmjetësimit shëndetësor dhe social, dhe të rrjetëzimit dhe avokimit	19,490
Syri i Vizionit (SiV)	Realizimi i aktiviteteve mësimore, të ndërmjetësimit shëndetësor dhe social, dhe të rrjetëzimit dhe avokimit	19,490
Agjencioni për Përkrahje të Punësimit në Kosovë (APPK)	Trajnimi i pjesëtarëve të komunitetit për përgatitje për kyçje në tregun e punës, konsulenca e partnerëve të projektit lidhur me punësueshmërinë	10,930
Subtotali		49,910
Operacione	Shpenzime operacionale të pakove shkollore, trajnimeve sociale, arsimore sipas kontratës me KKS	70,022.02
Subtotali		70,022.02
Grand totali (Plus+3)		141,092.02

Përkrahja e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2 - Arsimit për Integrim (EU SIMRAES 2)

Përshkrimi mi shkurtë i projektit

Projekti “Përkrahja e BE-së në zbatimin e strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2 – Arsimit për Integrim” (EU SIMRAES 2), ka filluar implementimin me 1 prill 2016. Në tetor të këtij viti projekti ka përfunduar. Projekti është financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe është implementuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) në partneritet me 7 organizata tjera:

- Qendra për Arsimit e Kosovës (KEC)
- Balkan Sunflowers Kosova (BSFK)
- Bethany Christian Services (BCS)
- Nevo Koncepti (NVK)
- SHL Kosova (SHL-K)
- Syri i Vizionit (SiV)

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka qenë partneri kryesor institucional në projekt, që krahas përkrahjes së aktiviteteve të projektit, ka financuar edhe një pjesë të programit të bursave në kuadër të projektit. Komuna e Gjakovës, Prizrenit, Rahovecit, Istogut, Obiliqit, Fushë Kosovës dhe Mitrovicës kanë qenë po ashtu partnerë institucionalë në nivelin lokal.

Objektivi i përgjithshëm i projektit EU-SIMRAES 2 ishte të mbështesë Qeverinë e Kosovës në zhvillimin e shoqërisë demokratike dhe multietnike duke zbatuar Strategjinë për Integrimin e Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe Planin e saj të Veprimit.

Objektivi specifik i veprimit ishte të sigurojë qasje të barabartë të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm, duke përmirësuar regjistrimin, vijimin dhe arritjen e rezultateve të fëmijëve nëpërmjet mbështetjes së bazuar në komunitet dhe asaj financiare.

Grupet e shënjestruara ishin:

- 10 lokalitete ku jetojnë romë, ashkali dhe egjiptian;
- fëmijët e moshës parafillore;
- fëmijët e moshës 6-14 vjeçare që vijuan arsimin e obliguar;
- prindërit e fëmijëve të moshës shkollore nga 10 lokalitetet e synuara;
- mësuesit e shkollave që shërbejnë komunitetet e synuara;
- nxënësit e shkollave në komunitetet e synuara;
- 200 nxënës romë, ashkali dhe egjiptian të shkollave të mesme;
- 7 organizata të shoqërisë civile;
- publiku i gjerë në Kosovë.

Projekti i kishte tri rezultate, që identifikohen edhe si komponentë të projektit:

- Përfshirja e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nga 10 lokalitetet e shënjestruara, në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm, dhe përmirësimi i rezultateve të tyre të të nxënësve
- Qasje dhe mbajtje e përmirësuar e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të lartë dhe përmirësim i kapacitetit të tyre për të përfituar nga arsimi i lartë
- Organizatat që punojnë në edukimin e

komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian e përmirësojnë kapacitetin e tyre për t'u ofruar shërbime cilësore anëtarëve të komuniteteve të tyre.

Si aktivitete kryesore të projektit ishin:

1.1 Mbështetet puna e 10 qendrave mësimore

1.2 Bëhet vetëdijesimi i prindërve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për të regjistruar fëmijët me kohë në shkollë

1.3 Ofrohet mbështetje logjistike fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për të vijuar arsimin parafillor.

1.4 Ofrohet mentorim individual dhe ndihmë në detyra të shtëpisë për fëmijët e moshës shkollore dhe atyre të kthyer.

1.5 Organizohet trajnim kundër paragjytimeve për mësime dhe prindërit, dhe ofrohet mentorim/këshillim për të siguruar zbatimin e kompetencave të marra

1.6. Organizohen ngjarje lokale për të ndihmuar integrimin më të mirë të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në nivelin shkollor.

2.1 Ofrohet mbështetje për regjistrimin e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të lartë

2.2 Krijohet një program i bursave për nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian të shkollave të mesme të larta.

2.3 Ofrohet mentorim për përfituesit e bursave.

3.1 Themelohet një rrjet joformal i OShC që punojnë në përmirësimin e mundësive të arsimimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

3.2 Lehtësohet komunikimi në mes të anëtarëve të rrjetit dhe shpërndahehet informacioni

3.3 Zhvillohet strategjia e bashkëpunimit për rrjetin

3.4 Ofrohen mundësi të zhvillimit profesional të anëtarëve të rrjetit, për të përmirësuar shkathhtësitë e tyre të shërbimit dhe avokimit

Të arriturat kryesore

Projekti ishte i paraparë të përfundojë më 31 mars 2019. Sidoqoftë, projekti ka arritur të bëjë kursime të theksuara, prandaj me kohë është bërë kërkesë te Autoriteti Kontraktual për zgjatje të implementimit të projektit. Zgjatja e projektit është miratuar dhe rrjedhimisht projekti është implementuar deri më 31 tetor 2019.

Përfshirja në edukimin e hershëm dhe arsimin e obliguar

Këtë komponent të projektit e ka koordinuar Qendra për Arsim e Kosovës. Organizatat tjera partnere kanë pasur rol të theksuar në menaxhimin në nivel lokal përmes qendrave mësimore. Janë 10 qendra mësimore në 7 komuna, të cilat janë menaxhuar nga 6 organizatat tjera partnere.

Emri i qendrës mësimore	Organizata partnere menaxhuese
Qendra Sociale në Plementin (PBLC)	BalkanSunflowers Kosova
Qendra Mësimore në Plementin (PLC)	BalkanSunflowers Kosova
Fidan Lahu (Fushë Kosovë)	BalkanSunflowers Kosova
Gurrakoc (Istog)	Syri Vizionit
Serbobran (Istog)	Syri Vizionit
Piranë (Prizren)	Nevo Koncepti
Jeta e Re (Prizren)	Nevo Koncepti
Lagjja e Romëve (Rahovec)	SHL-Kosova
Brekoc (Gjakovë)	BethanyChristianServices
Lagjja e Romëve (Mitrovicë)	RADC

Zgjatja e projektit ka mundësuar që përkrahja nëpër qendrat mësimore për fëmijët e nivelit parafillor dhe të arsimit të obligueshëm të zgjasë deri në fund të vitit shkollor 2018/19 duke mundësuar përmbylljen e kësaj mbështetjeje dhe mbledhjen e të dhënave nga qendrat mësimore.

Disa të arritura kryesore në kuadër të këtij komponentit të projektit janë

- Ofrimi i programit të detyrave të shtëpisë deri në fund të vitit shkollor 2018/19. Mbi 1500 fëmijë kanë qenë përfitues të këtij programi. Po ashtu janë realizuar shumë aktivitete ndërkulturore në të gjitha qendrat mësimore, me pjesëmarrje të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, fëmijëve të komunitetit shumicë dhe prindërve të tyre.
- Integrimi i aktiviteteve të qendrës mësimore në ndërtesat sociale në Plementina, në kuadër të shkollës PandeliSotiri. Me këtë, numri i qendrave mësimore që zhvillojnë aktivitete në kuadër të shkollave partnere u rrit në 6 prej 10 qendrave, duke e konsoliduar konceptin hibrid të qendrave mësimore. Në këto qendra një pjesë e aktiviteteve, kryesisht ato që lidhen me mbështetjen përmes programit të detyrave të shtëpisë,
- zhvillohen në klasat e ofruara nga shkolla, ndërsa aktivitetet e tjera zhvillohen në qendrën e komunitetit.
- Dhënia 1620 pakove shkollore për fëmijët që shërbehen në qendrat mësimore. Ndonëse nuk ka qenë e planifikuar që për këtë vit shkollor të ofrohen pako shkollore, planifikimi buxhetor i përiudhës

së zgjatjes së projektit, ka mundësuar që të shrihet kjo mbështetje përmes pakove edhe për këtë vit shkollor, që së paku të sigurohemi për fillim të mbarë të vitit shkollor 2019/20

- Renovimi i qendrës mësimore në Mitrovicë. Ndërtesa e kësaj qendre mësimore ishte një pronë në kontest midis Agjensisë Kosovare të Privatizimit dhe Komunës së Mitrovicës, prandaj nuk lejohej intervenimi më herët. Vitin e kaluar OShC-të që oprojnë në këtë ndërtesë morën njoftimin se mund të vazhdojnë ta shfrytëzojnë ndërtesën. Pas këtij lajmi dhe duke përfituar nga kursimet e fondeve të projektit, u planifikuar që në periudhën e zgjatjes së projektit të investohet në renovimin e kësaj qendre mësimore, për të siguruar ofrimin e qëndrueshëm të shërbimeve për fëmijët në periudhën e ardhshme.

Përmirësimi i qasjes në arsimin e mesëm të lartë

Në kuadër të komponentit të dytë të projektit ka vazhduar ofrimi i programit të bursave dhe të mentorimit.

Programi i bursave

Projekti ishte pjesë e programit të bursave në nivel vendi i cili u koordinua nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, dhe në të cilin morën pjesë edhe ofruesit e tjerë të bursave për nxënësit e shkollave të mesme nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Në këtë vit numri i bursistave u rrit në 600 përfitues. Tabela më poshtë tregon përfituesit e bursave, sipas ofruesve të bursave në kuadër të programit nacional të bursave.

	2016/17		2017/18		2018/19	
Ofruesi i bursave	Aplikime	Përfitues	Aplikime	Përfitues	Aplikime	Përfitues
	686	501	724	507	785	601
KFOS – MASHT (EU SIMRAES 2)	200		200		200	
VoRAE – MASHT	182		107		200	
REF – MASHT	119		200		201	
Totali	501		507		601	

Projekti edhe këtë vit i ka financuar 200 bursa. Gjatë vitit 2019 është përmbyllur ky vit i bursave duke mundësuar edhe mbledhjen e të dhënave për bursistët. Më poshtë është një tabelë me të dhënat lidhur me suksesin (notën mesatare) dhe braktisjen e përfituesve të bursave nga projekti EU SIMRAES 2, sipas viteve.

	2016/17		2017/18		2018/19	
	Gj. i parë	Fundviti	Gj. i parë	Fundviti	Gj. i parë	Fundviti
Nota mesatare	2.82	3.16	3.02	3.37	2.82	3.06
Braktisja	9		0		2	

Ndonëse Projekti nuk ishte partner në kuadër të programit të bursave për vitin 2019/20, megjithatë ndihmoi partnerët e bursave në përgatitjen për ofrimin e bursave të këtij viti, duke kontribuar në përgatitjen e pakos së aplikimeve për bursa, duke marrë pjesë në fushatën e informimit për bursa dhe duke ofruar përvojën e vet për parterët e bursave.

Programi i mentorimit

Qëllimi i programit të mentorimit ishte përmirësimi i vijueshmërisë dhe rezultateve të të nxënimit të nxënësve përfitues të projektit duke u ofruar atyre mbështetje akademike dhe joakademike si dhe mundësi më të shumta shoqërimi me bashkëmoshatarët.

Gjatë vitit shkollor 2018/19 prej 200 bursistëve, projekti ka ofruar program të mentorimit për më shumë se gjysmën e bursistëve. Më saktësisht nën këtë program, përmes 23 mentorëve janë mbështetur 115 bursistë të shkollave të mesme të larta në komunat: Gjakovë, Istog dhe Prizren.

Tabela më poshtë tregon numrin e përfituesve të programit të mentorimit për tri vite

Viti shkollor	Vajza	Djem	Gjithsej	Përfitues të bursave	Jo përfitues të bursave
2016/17	46	67	113	102	11
2017/18	51	63	114	111	3
2018/19	48	67	115	115	0

Programi ka ecur mirë dhe ka pasur përmirësim në rezultatet e të nxëniet. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur nota mesatare për këtë dhe dy vitet paraprake shkollore kur është ofruar programi i mentorimit për nxënësit përfitues të programit të mentorimit. Nga tabela shihet që përgjatë tri viteve shkollore kemi rritje të notës mesatare.

për hartimin e strategjisë së rrjetit, këtë vit është finalizuar në janar të këtij viti, duke e aprovuar strategjinë për operimin e rrjetit 2019-2021. Në muajin mars 2019 partnerët e rrjetit janë mbledhur në një punëtori për rivedimin e operimit të rrjetit, pra në mënyrën e organizmit të rrjetit pas kohëzgjatjes së projektit.

Viti shkollor	Nota mesatare, gjysmëvjetori i parë	Nota mesatare, fundviti
2016/17	2.46	2.85
2017/18	2.86	3.18
2018/19	2.61	2.96

Forcimi i kapacitetit të OShC-ve që punojnë në edukimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Ky komponent ka qenë i drejtuar kah forcimi i kapaciteteve të anëtarëve të organizatave partnere për të ofruar shërbime cilësore në fushën e arsimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Këtë vit rrjeti ka qenë i përqendruar në krijimin e qëndrueshmërisë së punës së rrjetit "Konect", sikurse edhe në ndikimin e qëndrueshëm të rrjetit në zhvillimet shoqërore në fushë.

Një drejtim i angazhimit në këtë vit ka qenë dialogu i brendshëm i organizatave partnere për të siguruar operimin e qëndrueshëm të rrjetit në periudhën e ardhshme disavjeçare. Për këtë arsye, procesi i nisur në fund të vitit të kaluar

Përfundimet nga kjo punëtori janë kthyer në një marrëveshje për operimin e rrjetit, e cila është nënshkruar nga udhëheqësit e organizatave partnere dhe do të shërbejë bashkë me strategjinë e veprimit si dokument udhëheqës në punën e Rrjetit

Dialogu me komunat partnere është mbajtur gjatë kohëzgjatjes së projektit, por një përpjekje e shtuar është bërë këtë vit për të siguruar mbështetjen e vazhdueshme të komunave për qendrat mësimore dhe për organizatat partnere. Për këtë arsye, në shtator 2019 është organizuar punëtorja treditëshe me komunat partnere ku janë gjeneruar ide për bashkëpunimin midis organizatave dhe komunave, dhe për format e mbështetjes së komunave për qendrat mësimore dhe në përgjithësi për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Edhe në nivelin qendror, organizatat partnere të rrjetit janë angazhuar për të siguruar mbështetjen për komunitetet të cilave iu shërbejnë. Pas miratimit të udhëzimit administrativ 19/2018 për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore, proces në të cilin organizatat partnere të Rrjetit ishin aktive, këtë vit përfaqësuesit e disa organizatave partnere, sikurse edhe menaxheri i Projektit EU SIMRAES 2, ishin pjesë e grupit punues që përgatiti udhëzuesin për implementimin e udhëzimit administrativ për qendrat mësimore. Ky udhëzues ka mbetur të nënshkruhet nga Ministri i Arsimit, në mënyrë që t'i hap rrugë procesit të regjistrimit të qendrave mësimore.

Lista e granteve:

Projekti	Grant marrësi	Shuma në Euro
Trajnimi, mentorimi dhe monitorimi i punës i qendrave mësimore	KEC	7,609.61
Përkrahje për zhvillimin e aktiviteteve arsimore	Nevo Koncepti	6,634.26
Përkrahje për zhvillimin e aktiviteteve arsimore	Bethany Christian Services	5,882.26
Përkrahje për zhvillimin e aktiviteteve arsimore	Syri Vizionit	8,524.59
Përkrahje për zhvillimin e aktiviteteve arsimore	SHL-Kosova	4,627.06
Përkrahje për zhvillimin e aktiviteteve arsimore	Balkan Sun flowers Kosova	10,631.28
Përkrahje për zhvillimin e aktiviteteve arsimore	Roma and Ashkali Documentation Center	5,861.66
Subtotali		49,770
Shpenzimet operacionale		
Bursat për nxënës të shollave të mesme, printim, dhe shpenzime tjera operacionelebazu në kontratën me BE	Operacionele	71,113.78
Subtotali		71,113.78
Grand totali		120,884.50

